TË Sh P R E H U R I T	<p>• <b>Rrëfim me gojë;</b> - të emërtojë njerëz, sende dhe dukuri nga mjedisi i drejtpërdrejtë; - të riprodhojë fjali numra, vjersha të zakonshme dhe ngjashëm.; - të jep përshkrime të zakonshme të njerëzve, sendeve, situatave, vendeve nga mjedisi i afërt duke përdorur leksikun e njohur; - të flet për ngjarje të tashme, të kaluara dhe të ardhshme duke përdorur vokabular të zakonshëm dhe fjali të shkurtra; -të krijojë strategji personale për shprehje gojore.</p> <p><b>TË SHKRUARIT</b></p> <p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të plotësojë formularë të rëndomtë me emër e mbiemër, mosha, data dhe vendi i lindjes, adresa, gjinia, shkolla, klasa;</li> <li>- të shkruajë porosi të shkurtë, uresë, përshkrim të shkurtë të thjeshtë të modeleve të dhëna;</li> <li>- të shkruajë duke i respektuar rregullat e drejtshkrimit të frëngjishtes dhe të përdorë mjetet e zakonshme gjuhësore;</li> <li>- të përshkruajë tekst të shkurtë të zakonshëm duke u bazuar në fjalët e dhëna;</li> <li>- të përdorë akte të caktuara komunikuese;</li> <li>- të fillojë të ndërtojë strategji personale për zotërimin e të shprehurit me shkrim të gjuhës frënge.</li> </ul>			<p>• <b>Aktivitete të llojit:</b> - plotësimi i fjalëve me shkronja të lëshuara/përvjedhur; - radhitja e fjalëve në varg të bashkuar; - të shkruarit e fjalëve sipas diktimit dhe sipas spelling; - plotësimi i formularëve të rëndomtë; - përfundimi i fjalive ose tekstit të shkurtë; -kompletimi i dialogëve të hapura; - plotësimi i teksteve me fjalë të lëshuar/përvjedhur; - të shkruarit e porosive, letër shokut etj.</p> <p>• <b>Rekomandime didaktike</b> Mësimdhënësi duhet të nxisë: - nxënësi/nxënësja ti zbatojë mjetet e përsosura gjuhësore dhe komunikative; - kreativiteti të nxënësit; - puna individuale dhe puna në grupe të vogla; - krijimi i atmosferës së këndshme për punë në orë.</p>

## 5. REKOMANDIME TË PËRGJITHSHME DIDAKTIKE

•Kahet për lidhshmëritë ndërlëndore (planifikim i integruar, përkatësisht lidhshmëri e përgjithshme e përmbajtjeve ndërmjet lëndëve dhe lëmive të ngjashme)

Të mësuarit e gjuhës frënge paraqet mundësinë për shfrytëzimin dhe krijimin e lidhjeve ndërmjet lëndëve që mësohen në klasën e VI, dmth., respektohet parimi e lidhshmërive ndërlëndore sa i përket qëllimeve dhe përmbajtjeve me theks të lidhshmërisë integruese me përmbajtjet: gjuhë amtare, përmes diturive të fituara nga ajo lëndë; gjuhë e parë e huaj , përmes strategjive për punë, punë me fjalor, lidhje sociokulturore; matematikë me nocionet për numrat natyrorë, data, format gjeometrike; historia me nocionet për shoqëri, festa, tradita; gjeografia, nocionet për kontinentet, harta gjeografike, klima; bazat e shkencave natyrore me nocionet për bimët, kafshë, ekologjia; muzikë, përmes stileve të muzikës, mësimi i këngëve frankofonike; arsimit fizik dhe shëndetësor, përmes llojeve të sportit, higjienë, shëndet; arsimit figurativ, përmes diturive për vizatim në funksion të kuptimit.

Ekzistojnë edhe shembuj tjerë të korrelacionit me lëndë tjera mësimore dhe për këtë preferohet që mësimdhënësi ta mësojë nxënësin/nxënësen të mendojë në mënyrë të pavarur dhe të gjejë lidhje ndërmjet mëimit nga gjuha frënge dhe lëndëve tjera mësimore.

### □ Rekomandime për shfrytëzimin e fondit vjetor të orëve

Procesi i mëimit të gjuhës frënge vijon përmes fondit javor/vjetor të orëve, përmes komponentëve të cilat mësohen dhe të cilat i përbëjnë shkathtësitë e fundit gjuhësore të cilat nxënësi duhet ti përvetësojë në fund të nivelit përkatës, megjithatë ato nuk mund të ndahen, përkatësisht nuk mund të planifikohet numri i orëve sipas disa komponentëve. Thënë më konkretisht, në mësim të gjitha komponentët e programit nuk

përpunohen ndaras dhe me numër të kualifikuar të orëve ose sipas asaj radhitje siç janë dhënë në program por të integruar në funksion të gjuhës, dmth., krijimi i kompetencës komunikative në situata konkrete, e cila në fakt paraqet qëllim përfundimtar të programit.

Qasja ndaj gramatikës është kognitive. Përmbajtjet gramatikore hartohen në kontekst, sipas mënyrës individuale, kurse rregullat gramatikore nuk duhet të mësohen dhe kontrollohen në mënyrë të izoluar, jashtë kontekstit. Përmbajtjet duhet të jenë të integruara në tërësitë e parapara tematike.

Përmbajtjet e propozuara në programe përthellohen në secilin vit vijues.

### □ Mjetet mësimore:

- mjetet mësimore (libër zgjedhur në nivel të shkollës për lëndën përkatëse dhe lejuar nga MASH, doracak për mësimdhënësin, fletore pune për nxënësin, CD, DVD, portfolio etj;
- fjalorë, enciklopedia, postere, flesh kartela;
- revista të huaja për mësimdhënësin dhe nxënësin;
- kasetofon, kasete, CD-pleer, kompjuter me qasje në Internet, TV (shfrytëzimi i teknologjive informatike-komunikative).

Preferohet që mësimdhënësi të mos përkufizohet vetëm në kompletin e librave por mësimdhënësi mundet dhe duhet të përgatisë materiale dhe të gjejë infomata dhe dokumente autentike nga burime të ndryshme në funksion të realizimit të qëllimeve të parapara në mësim.

## 6. VLERËSIMI I TË ARRITURAVE TË NXËNËSVE

Kontrollimi dhe hulumtimi i rezultateve të arritura është element shumë i rëndësishëm gjatë mësimit/mësimnxënies.

Mësimdhënësi duhet vazhdimisht ta mbikëqyrë punën e nxënësve dhe ti nxisë në përparimin e tyre, kurse vlerësimin duhet ta përshtatë në metodat elementare për objektivizëm dhe validitet.

Gjatë kontrollimit të rezultateve të nxënësve duhet t'iu mundësohet liri e të shprehurit dhe arritshmërinë e qëllimeve konkrete komunikuese. Gabimet e bëra ose ato të përvjedhur korrigjohen përmes dhënies së formës së drejtë. Preferohet mësimdhënësi ti orientojë nxënësit vetë ti zbulojnë gabimet. Mësimdhënësi duhet ti inkurajojë nxënësit. Me rëndësi të veçantë është që format e kontrollimeve të jenë të llojllojshme dhe në mënyrë sistematike ti ndjekin të arriturat e nxënësve në aktivitete të ndryshme.

Gjatë vlerësimit të të arriturave të nxënësve në zotërimin e të shprehurit gojor dhe me shkrim duhet të orientohen ndaj evalvimit formativ me qëllim edhe mësimdhënësi dhe nxënësit të informohen për nivelin e diturive dhe aftësive të arritura, që të mund me kohë të tejkalohen lëshimet eventuale në mësim dhe mësimnxënie.

Me rëndësi të veçantë është që mësimdhënësi në mënyrë sistematike ta kontrollojë nivelin e njohurive të nxënësve, të zbatojë forma të ndryshme të kontrollimit dhe të përdor kriter të veçantë gjatë formimit të notës. Ai duhet ta ndjekë sjelljen e nxënësit ndaj procesit arsimor dhe ta vlerësojë pjesëmarrjen e tij në aktivitete të ndryshme:

- punë në orë (frontale, në grupe, nga dy, individuale);
- përpunimi i detyrave të shtëpisë;
- punë e nxënësit në projekte.

Të arriturat e nxënësve ndiqen përmes testeve natyrore me përmbajtje dhe kohëzgjatje të ndryshme. Përparësi duhet dhënë vlerësimit të aftë-

sive komunikuese të nxënësve në kuadër të qëllimeve të parapara në shkathtësitë (psh., përbërja e tekstit të thjeshtë sipas ilustrimeve/ilustrime serike, të shkruarit e letrës personale sipas elementeve të dhëna, ftesë, porosi e shkurtë, detyrë për kontrollimin e kuptimit të tekstit të lexuar ose të dëgjuar). Vendin e tyre duhet gjetur edhe kontrollimet e njohurive të përvetësuara nga gramatika dhe leksiku me të cilat e kontrollojmë përvetësimin e strukturave gjuhësore të parapara në program. Përkthimi nuk parashikohet dhe nuk duhet të jetë mjet për vlerësimin e njohurive të nxënësve.

Diktimi përdoret si aktivitet ushtrimi. Mund të përfshihet edhe në kuadër të procesit të mësimi.

Notat duhet mirë të arsyetohen dhe argumentohen para nxënësve, të kenë karakter inkurajues dhe stimulues dhe ta motivojnë të mësuarit të gjuhës frënge. Sipas Konceptit për arsimin dhe edukimin fillor nëntëvjeçar në mbarim të klasës së VI përveç vlerësimit intern do të realizohet edhe kontrollimi intern i të arriturave, por me teste eksterne të standardizuara.

Sipas Kornizës së përbashkët evropiane për gjuhët e huaja niveli i diturive të nxënësve të klasës së VI duhet të përputhet me njohuritë bazike në nivel A1 të kësaj komize.

## 7. KUSHTET HAPËSINORE PËR PAJISJE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT MËSIMOR

Programi bazohet në normativin për hapësirë për periudhën e dytë (klasa IV, V, VI) dhe për mjetet mësimore për klasën e VI aprovuar nga ministri.

Kushtet hapësinore dhe pajisja e klasave për realizim të suksesshëm të programit mësimor për klasën e VI duhet të jenë në përputhje me normativin e përgjithshëm për pajisje për realizimin e programit mësimor për klasën e VI.

Rekomandohet, për shkak kontaktit më të lehtë vizual ndërmjet nxënësve, për të dëgjuar më mirë atë që flitet edhe nxënësi i vendosur më larg të ketë pasqyrë të klasës, bankat të jenë të radhitura në këtë mënyrë: më shumë banka të afuara bashkë, variante të ndryshme të shkronjës „U“, si dhe radhitja dhe grupimi i karrigeve sipas nevojës, varësisht nga aktivitetet e parapara.

## 8. NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR

- Studime të mbaruara nga gjuha frënge-drejtimi arsimor, VII<sup>1</sup>.
- Studime të mbaruara nga gjuha frënge dhe letërsia, VII<sup>1</sup>.
- Studime të mbaruara nga gjuha frënge dhe literatura – drejtimi tjetër dhe me përgatitje përkatëse pedagogjike psikologjike dhe metodike në fakultetin përkatës, VII<sup>1</sup>.

## 9. REZULTATET E PRITURA

Rezultatet e pritura kanë të bëjnë me kolonën nr. 2 Programi mësimor, përkatësisht nga qëllimet e parapara të vitit mësimor, të cilat njëherësh paraqesin nivele të diturisë të rezultateve të arritura të nxënësve, të cilat duhet të përputhen në dituritë bazike në nivelin A1 të kornizës referente.

Programin mësimor nga *gjuha frënge* për klasën e VI në arsimin fillor nëntëvjeçarë e sollti ministri i Arsimit dhe Shkencë me vendim. 07-668/8 më 05.11.2010.

ARSIMI FILLOR NËNTËVJEÇAR



**GJUHË GJERMANE**

**PROGRAMI  
MËSIMOR**

Në bazë të nenit 55 paragrafit 1 të Ligjit për organizimin e punës së organeve të drejtorisë shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 58/00, 44/02 dhe 82/08) dhe neni 25 paragrafi 2 të Ligji për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 103/08 dhe 33/2010) ministri i Arsimit dhe Shkencës e miratoi programin mësimor për lëndën *gjuhë gjermane* për klasën e VI në arsimin fillor nëntëvjeçar.

# 1. HYRJE

## VENDI I LËNDËS NË PLANIN MËSIMOR

### □ *Përshkrimi dhe natyra e lëndës*

SSecili lloj i integritit më të gjerë në strukturat evropiane nënkupton kuadro të arsimuara mire të cilët njohin dhe flasin gjuhë të huaja. Para shoqërisë tone qëndron detyrë e madhe – arritja e idealit në Këshillit të Evropës për multilinguitet, sipas të cilit si minimum nënkuptohet njohja e mire e dy gjuhëve të huaja.

Gjatë studimit të gjuhës së huaj nxënësit formohen si personalitete të pavarura, e zhvillojnë vetëbesimin, pavarësinë, kreativitetin. E ndërtojnë motivimin e shprehive të punës dhe aftësive, përgatitjen për bashkëpunim, komunikim, tolerance, punë ekipore. Tek nxënësit ndërtohet kultura e sjelljes dhe respekti i bashkëbiseduesit, sjellja e mire në shkollë, familje, respekti i obligimeve shkollore, ndjenja e saktësisë dhe kujdesi i shoqërisë.

Gjuha gjermane është gjuhë me kulture të pasur dhe traditë shkencore me të cilën flasin rreth 200 milion njerëz. Afërsia me gjuhën angleze e lehtëson të kuptuarit e gjuhës gjermane si gjuhë e huaj, e shkurton procedurën për zhvillimin e aftësisë për dëgjim dhe mundëson që më shpejtë të zhvillohet aftësia e të folurit. Në kohën më të re gjuha gjermane me sukses e tejkalon rrugën në shkollat në Evropë. Gjatë përpilimit të programit shfrytëzohen njohuritë nga realizimi i programeve mësimore të deritanishme nga gjuha gjermane si gjuhë e pare dhe e dytë.

Në planin mësimor për arsimin fillor nëntëvjeçarë i është dhënë vend i posaçëm gjuhëve të huaja për shkak të faktit se në kuadër të globalizimit përshpejtohen ndryshimet ndërcivilizuese në të gjithë segmentet në jetesën shoqërore (ekonomike – politike, kulturore, arsimore etj) me çka imponohet nevoja e multigjuhësisë, çka është intencioni i konceptit të ri. Nga këto arsye mësimi i gjuhës së huaj të pare fillon që nga moshën gjashtëvjeçarë (klasa e I), ndërsa në moshën 11 vjeçe (klasa e IV) fillon të mësohet edhe gjuha e huaj e dytë.

□ *Titulli i lëndës: gjuha gjermane*

□ *Fondi javor, gjegjësisht fondi vjetor i orëve: 2/72*

□ *Statusi i lëndës: i detyrueshëm/gjuha e huaj e dytë*

## QËLLIMET E PËRGJITHSHME PËR PERIUHDËN ZHVILLIMORE

Mësimi/studimi i gjuhës gjermane në këtë nivel bazohet në këto qëllime themelore vijuese:

- nxënësi/nxënësja të aftësohen për komunikim me tjerët, respektin e shumëgjuhësisë dhe pasurimin e kulturës së përgjithshme dhe kulturës gjuhësore;
- të formojë raport kritik ndaj kulturës personale dhe kulturave tjera dhe të aftësohet për respektin e dallimeve, të drejtave të njeriut, kulturave tjera dhe traditave;
- të stimulohet mësimi i gjuhës gjermane, të zhvillohet interesi ndaj vendeve ku flitet gjuha adekuate për shkak të grumbullimit të informatave nga burimet e ndryshme të asaj gjuhe dhe zhvillimi i lidhjeve ndërkulturore.

## QËLLIMET SPECIFIKE TË MËSIMIT TË GJUHËS GJERMANE

Nxënësi/nxënësja

- të formojë dhe të zhvillojë kompetenca gjuhësore, komunikuese, interkulturore për mësimin e gjuhës së huaj të dytë;
- të zhvillojë aftësi për ndërlidhjen e njohurive të arritura nga gjuha e huaj e parë, gjuha amtare dhe lëndët tjera gjatë mësimin të gjuhës së huaj të dytë;
- të formojë shprehje elementare dhe njohuri për dëgjim, të folur, lexim dhe të shkruar përmes sistemit të ndërtuar nga njohuritë e njësive gjuhësore dhe fjalive, fonetike, drejtshkrimore, leksikore dhe gramatikore;
- të zhvillojë aftësi për të mësuarit e pavarur dhe vetëvlerësimin sipas kornizës së përbashkët referente (Portfolio).

## 2. QËLLIMET KONKRETE

	Qëllimi	Përmbajtja	Nocionet	Aktivitetet dhe metodat
D Ë G J I M I	<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë lajmërimet të shkurtër, shprehje të përditshme dhe fjali të thjeshta;</li> <li>- t'i kuptojë dhe përcjell udhëzimet shkurtër dhe të qarta të mësimdhënësit;</li> <li>- të dijë të kuptojë fjali të shkurtër, të thjeshta që i drejtohen drejtpërdrejt nxënësit, familjes së tij ose punëve të caktuara nga mjedisi i tij i drejtpërdrejtë, nëse flitet qartë dhe ngadalë.</li> <li>- të din t'i njëj modelet themelore të intonacionit në fjalinë pyetësorë dhe urdhërore, lutje apo urdhër:</li> <li>- të din të shfrytëzojë strategji kompensatore për të kuptuarit e fjalëve të panjohura nga folësi, psh. Elementet jashtëverbale gjestet dhe mimikat;</li> <li>- të mund të gjendet me ndihmën e kontekstit, internacionalizmat, tingujt, zërat etj;</li> <li>- të din që përmes dëgjimit t'i njëj fonemat e sistemit fonetik gjerman;</li> <li>- të din përmes dëgjimit ta identifikojë theksin në fjalë.</li> </ul>	<p><b>a) Njësitë tematike</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- <i>Unë dhe tjerët</i> (përshëndetje, prezantim: moshë, prejardhja, vendbanimi, interesat)</li> <li>- <i>Familja ime</i> (prindërit, nëna, babai, vëllai, motra, gjyshja, gjyshi, xhaxhai, tezja)</li> <li>- <i>Shkolla ime</i> (gjësendet e shkollës, mjetet e shkollës, radhitja e orëve, sistemi shkollor në Gjermani)</li> <li>- Aktivitete të përditshme (në shtëpi dhe në shkollë, në kohën e lirë)</li> <li>- <i>Festat dhe traditat:</i> Krishtlindjet, pashkët, Viti i ri, Panorama për vitin e ri</li> <li>- Numrat prej 1 deri 100, vitet, numrat telefonik, operacionet aritmetike: mbledhja, zbritja</li> </ul> <p><b>b) Funkcionet gjuhësore</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• sich begrüßen,</li> <li>• sich vorstellen</li> <li>• Fragen stellen und antworten,</li> <li>• jemanden ansprechen</li> <li>• sich verabschieden</li> <li>• bitten und danken</li> <li>• einen Gegenstand benennen</li> <li>• verneinen und bejahen</li> </ul>	<p><b>Strukturat gramatikore</b></p> <p><i>Foljet</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- koha e tashme (folje të rregullta, folje me ndryshimin e vokalit, folje ndarëse; foljet <b>haben</b> dhe <b>sein</b>; <b>möchte</b> + <b>Infinitiv</b>; <b>können</b>)</li> <li>- mënyra urdhërore, veta e 2 njëjës</li> </ul> <p><i>Emrat</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- me nyjën e trajtës së shquar dhe të pashquar në nominativ dhe akuzativ</li> </ul> <p><i>Mbiemrat</i></p> <p>Në përdorim predikativ</p> <p><i>Përemrat</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- përemra vetor</li> <li>- përemra pronor <b>mein, dein, sein, ihr</b></li> <li>- Përemra dëftor <b>das</b></li> </ul> <p><i>Ndajfolje</i></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- vendi</li> <li>- kohe</li> </ul>	<p><b>Format e punës:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- puna me tërë klasën;</li> <li>- puna individuale;</li> <li>- puna në çifte;</li> <li>- puna në grupe;</li> <li>- puna e pavarur;</li> <li>- puna e projektit.</li> </ul> <p><b>Korniza komunikative:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- partner në bisedë (nxënës – nxënës; nxënës – mësimdhënës);</li> <li>- shpjegues.</li> </ul> <p><b>Mjete për punë</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- libër;</li> <li>- kartela tematike;</li> <li>- mjete mësimore (libra me poezi të shkurtër, gjëgjëza, proverba në përputhje me moshën e nxënësve);</li> <li>- inçizime autentike tonike;</li> <li>- incizime, videomateriale me informata për vendet nga fusha e të folmes gjermane;</li> <li>- materiale për prerje, ngjitje, modelim;</li> <li>- lojëra me karta;</li> <li>- afishe posterë;</li> <li>- lojëra (topa të butë, kukulla për shfaqje me kukulla, kukulla për dorë, kafshë prej plishi/plastike etj);</li> <li>- kompjuter me qasje në Internet.</li> </ul>

	Qëllimi	Përmbajtja	Nocionet
L E X I M I	<p>Nxënësja/nxënësi: - të din në tekste të shkurtra të thjeshta që kanë të bëjnë me situatat e përditshme të zakonshme të njuh: emra, numra, fjalë dhe struktura të thjeshta; - të din nga tekstet e shkurtra informatike t'i nënvizojë të dhënat më të rëndësishme për personazhët dhe vendet; - të din të kuptojë udhëzime të shkurtra të thjeshta të cilët janë të ilustruara; - të mund ta kuptojë përmbajtjen e teksteve të thjeshta informative të temave të njohura ku janë të përdorura internacionalizmat dhe elementet vizuale.</p>	<p>• Verstehen und Nichtverstehen signalisier ren • sich etwas wünschen • gratulieren • Abneigung, Vorliebe äußern, • Gefallen und Missfallen ausdrücken, • etwas beschreiben (einfache Gegenstände und Handlungen)</p> <p><b>b) Kultura dhe civilizimi</b> Përmbajtjet kulturore dhe edukative janë të integruara në njësitë e parapara tematike dhe funksionet gjuhësore, shembull, përs hendetje, sjellja e bukur, të drejtuarit, urimet e festave dhe ditëlindjeve, mjedisi i shkollës, strehimi, veshmbathja, emra dhe mbiemra të moshatarëve nga vendet e të folmes gjermane, disa emra të qyteteve etj. Në qasjen ndaj përmbajtjeve kulturore, edukative dhe sociale duhet të mbahet llogari për qasje kontraste dhe të bëhet krahasim me përmbajtjet adekuate të kulturës në Maqedoni dhe në vendet në fushën e të folmes gjermane.</p> <p><b>ç) Dimensioni interkulturor</b></p> <p>Nxënësi/nxënësja duhet të sensibilizohet për vërejtjen e ngjashmërive dhe dallimeve ndërmjet dy kulturave përmes përmbajtjeve edukative dhe sociale, si bazë për zhvillimin e tolerancës dhe eupatisë ndaj pjesëtarëve të kulturës së huaj.</p>	<p><i>Parafjala</i> - <b>in, im, ins</b> - <b>für, von</b> + përemër vetor - <b>mit, aus</b> pa nyje</p> <p><i>Negacioni</i> <b>nein, nicht, kein</b></p> <p><i>Përemra pyetës</i> <b>wer, was, woher, wo, wann</b></p> <p><i>Sintaksë</i> - fjali habitore - fjali pyetës pa dhe me përemër pyetësor - lidhëza und, aber dhe denn</p> <p><i>Renditja e fjalëve në fjali</i> - fjali pyetësor - fjali dëftore - gjatë përdorimit të foljes modale - fjali urdhërore</p> <p><b>Leksik</b> Në fund të klasës së gjashtë nxënësit duhet të dinë rreth 150 njësi leksikore nga njësitë tematike që përpunohen.</p> <p><b>Drejshkrimi</b> Përvetësimi i rregullave dhe normave të drejtshkrimit të ri gjerman - <b>ö, ä, ü, ß, ch, sch, tsch, sp, st, ss</b> - diftongjet: <b>ei, äu, eu</b> - vokalet e gjata - bashkëtingëlloret dyfishe - të shkruarit e emrave me shkronjë të madhe</p>

	Qëllimi	Përmbajtja	Nocionet	Aktivitetet dhe metodat
T Ë F O L U R I T	<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të merr pjesë në bisedë (interaksion) dhe të flet në mënyrë të pavarur (produksion i të folurit);</li> <li>- të din të përshëndesë;</li> <li>- të din të prezantohet dhe të shkurtimisht ta prezantojë vetveten dhe personin tjetër (emri, prejardhja, vendbanimi, interesi);</li> <li>- të din të pyet person tjetër për gjendjen dhe të përgjigjet pyetjes së njëjtë;</li> <li>- të din të jep të dhëna elementare në situata të përditshme që bazohen në numra (adresa, numri i telefonit, koha, data);</li> <li>- të din të parashtojë pyetje të drejtpërdrejta për të dhëna personale.</li> </ul>		<p><b>Interpunksioni</b></p> <p>Përvetësimi i normave dhe rregullave të pikësimit në gjuhën gjermane</p>	
	<p>Nxënësi/nxënësja</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të din të përshkruaj fjalë të thjeshta dhe fjali;</li> <li>- të mund të plotësojë zbrazëtira në tekst të shkurtër me fjalë përmes formularit vizual ose të zëshëm;</li> <li>- të mund të përshkruaj uresë sipas modelit të shkruar;</li> <li>-të din t'i vërej dallimet themelore ndërmjet grafemave dhe shqiptimit të fjalëve më frekuentuese.</li> </ul>			

### 3. REKOMANDIMET DIDAKTIKE

**5.1. Udhëzime për lidhshmërinë** ndërlendore (planifikimi integruar, gjegjësisht lidhshmëria e plotë përmbajtjesore ndërmjet lëndëve të ngjashme dhe lëmive)

Mësimi i gjuhës ruse paraqet mundësi për shfrytëzimin dhe krijimin e lidhjeve ndërmjet lëndëve që mësohen në klasën e VI, gjegjësisht i respektuar është parimi i ndërlidhjes ndërlendore sipas raportit të qëllimeve dhe përmbajtjeve me theks të lidhjes integruese me përmbajtjet në:

- gjuhën amtare, përmes njohurive të fituara dhe diturive nga ajo lëndë;
- gjuha e huaj e parë, përmes strategjive për mësim, puna me fjalorë, lidhjet sociokulturore;
- matematikë me nocionet për numrat natyror, data, format gjeometrike;
- histori me nocionet për shoqëri, festa, tradita;
- gjeografia me nocionet për kontinente, harta gjeografike, klima, rrugëtime;
- bazat e shkencave natyrore me nocionet për bimët, kafshët, ekologjinë;
- muzika – stilet e muzikës, mësimi i vjershave ruse;
- arsimit fizik dhe shëndetësor – llojet e sporteve, higjiena, shëndeti,
- arsimit figurativ – shkathtësi për të vizatuar në funksion të të kuptuarit etj.

Ekzistojnë edhe shembuj tjerë për korrelacion me lëndë tjera mësimore. Obligimi i mësimdhënësit është që t'i adaptojë nxënësit që në mënyrë të pavarur të mendojnë dhe ta gjen atë lidhje ndërmjet gjuhës ruse dhe lëndëve tjera.

**5.2. Rekomandime për shfrytëzimin e fondit vjetor të orëve**

Procesi i mëimit të gjuhës gjermane zhvillohet përmes fondit javor dhe vjetor të orëve, përmes komponentëve që mësohen dhe të cilët i përbëjnë shkathtësitë përfundimtare gjuhësore që nxënësi duhet t'i përvetë-

sojë në fund të nivelit adekuat, megjithatë ata nuk mundin të ndahen, gjegjësisht nuk mund të planifikohet numri i orëve sipas komponentëve të caktuar. Thënë më konkretisht në mësim këto komponentë nuk përpunohen në veçanti dhe me numër kuantitativ të orëve ose sipas asaj rradhitje siç janë dhënë në program, por të integruara në funksion të gjuhës gjegjësisht krijimi i kompetencave komunikative në situatat konkrete që gjegjësisht paraqet qëllim përfundimtar në program.

Qasja ndaj gramatikës është kognitive. Përmbajtjet gramatikore përpunohen në kontekst, sipas rrugës induktive ndërsa rregullat gramatikore nuk duhet të mësohen dhe kontrollohen të izoluara, jashtë nga konteksti. Përmbajtjet duhet të jenë të integruara në tërësitë e parapara tematike.

Përmbajtjet e propozuara në programet thellohen secilin vit vijues.

**5.3. Mjetet mësimore**

- Sistemi i kompletuar i teksteve shkollore (libër i zgjedhur në nivel të shkollës për lëndën adekuate dhe i lejuar nga MASH, doracak për mësimdhënësin, fletore pune për nxënësin, CD, portfolio etj)
- fjalor, enciklopedi, posterë;
- revista të huaja për mësimdhënësin dhe nxënësit
- Kasetofon, kaseta, kompjuter me qasje në Internet, CD rom, TV me TVSH.

Nevojitet që mësimdhënësi të mos kufizohet vetëm me kompletin e teksteve shkollore, por ai mundet dhe duhet të përgatit materiale plotësuese dhe të gjen informata dhe dokumente autentike nga burime të ndryshme, në funksion të realizimit të qëllimeve të parapara në mësim.

## 4. VLERËSIMI I TË ARRITURAVE TË NXËNËSVE

Gjatë vlerësimit të të arriturave të nxënësit në këtë nivel duhet t'ju mundësohet liri në të arriturat dhe shprehjet e qëllimeve konkrete komunikative. Gabimet e bëra dhe të lëshuara korrigjohen përmes shprehjes së formës së rregull. Më e preferuar është që mësimdhënësi t'ju ndihmojë nxënësve vetë t'i zbulojnë gabimet dhe të korrigjohen reciprokisht. Mësimdhënësi do të duhet t'i inkurajojë nxënësit. Me rëndësi të veçantë është që format e vlerësimit të jenë të llojllojshme dhe sistematike t'i përcjellin të arriturat e nxënësve në aktivitete të ndryshme. Gjatë vlerësimit të të arriturave të nxënësve në të shprehurit me shkrim dhe me gojë vëmendje duhet kushtuar ndaj evolucionit formativ me qëllim që mësimdhënësi dhe nxënësi të informohen për nivelin e njohurive dhe aftësive të arritura, që të mundet tejkalohen në kohë lëshimet eventuale në mësim dhe mësimnxënies. E rëndësishme është që mësimdhënësi sistematikisht ta kontrollojë nivelin e njohurive dhe shkathtësive të nxënësve, të zbatojë forma të ndryshme të vlerësimit dhe të shfrytëzojë kri-tere të veçanta gjatë formimit të notës.

Ai duhet ta përcjell raportin e nxënësit ndaj procesit mësimor dhe ta vlerësojë pjesëmarrjen e tij në aktivitetet e ndryshme:

- puna në orë (frontale, në grupe, nga dy, individuale);
- përpunimi i detyrave të shtëpisë;
- puna e nxënësit në projekte.

Të arriturat e nxënësve përcillen përmes *testeve periodike* me përmbajtje dhe kohëzgjatje të ndryshme. Përparësia duhet të jepet në ndërtimin e aftësive komunikative të nxënësit në kuadër të qëllimeve të parapara (psh., përpilimi i testit sipas fotografive/varg fotografish, shkruarja e letres personale sipas elementeve të dhëna, ftesë, porosi e shkur-tër, detyrë për vlerësimin e të kuptuarit ose teksti që është dëgjuar). Vendin e vet duhet ta gjejë edhe vlerësimet e njohurive të përvetësuara nga gramatika dhe leksiku me çka e kontrollojmë përvetësimin e strukturës gjuhësore të parapara në program.

Përkthimi nuk parashihet dhe nuk duhet të jetë mjet për vlerësimin e njohurive të nxënësve.

Diktimi shfrytëzohet si aktivitet ushtrues. Mund të ndërli-dhet edhe në kuadër të procesit të mësimnxënies.

Vlerësimet duhet të jenë të arsyetueshme dhe të argumentuara mirë para nxënësve, të kenë karakter kurrajues dhe ta motivojnë mësimnxënien e gjuhës ruse. Sipas Konceptit për arsimin dhe edukimin fillor nëntëvje-çarë në fund të klasës së VI përveç vlerësimit inter do të realizohet kon-trollimi i të arriturave, por me teste të përgatitura standarde.

*Sipas kornizës evropiane të Përbashkët për gjuhët e huaja niveli i njohurive të nxënësve nga klasa e VI duhet të përputhet me njohuritë themelore në A1 nga kjo kornizë.*

## 5. KUSHTET HAPËSINORE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT MËSIMOR

Programi sa i përket kushteve hapësinore për realizim bazohet në Normativin për hapësirë, pajisje dhe në mjetet mësimore për klasën e IV të miratuar nga ministri i Arsimit.

Kushtet hapësinore dhe pajisja e klasave për realizim të suksesshëm të programit mësimor për klasën e VI duhet të jenë në përputhje me normativin e përgjithshëm për pajisjen për realizimin e programeve mësimore për klasën e VI

Rekomandohet, për shkak të kontaktit më të lehtë vizual ndërmjet nxënësve, që të dëgjojë më mirë çka flitet dhe nxënësi që është më larg të ketë pasqyrën e klasës, bankat të jenë të radhitura në këtë mënyrë: më tepër banka të afuara bashkë, variante të ndryshme të shkronjës „P” si dhe zhvendosja dhe grupimi i bankave sipas nevojës, varësisht nga aktivitetet e parapara.

## 6. NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR

- Studimet e përfunduara nga gjuha gjermane dhe letërsia- udhëzimi mësimor, VII<sup>1</sup>
- Studimet e përfunduara nga gjuha gjermane dhe letërsia, VII<sup>1</sup>.
- Studime të përfunduara nga gjuha gjermane dhe letërsia – drejtim tjetër dhe me marrjen e përgatitjes adekuate pedagogjike – psikologjike në fakultet adekuat, VII<sup>1</sup>

## 7. REZULTATE TË ARRITURA

Rezultatet e arritura përputhen me kolonën nr.2 nga Programi mësimor, gjegjësisht nga qëllimet e parapara të viti mësimor, të cilët njëherë paraqesin nivele të njohurive të rezultateve të arritura tek nxënësit, të cilët duhet të përgjigjen në njohuritë në nivelin A1 nga korniza referenciale

Programin mësimor nga lënda e *gjuhës gjermane* për klasën e VI në arsimin fillor nëntëvjeçarë e sollë ministri i Arsimit dhe Shkencës me vendim. 07-668/4 më 05.11.2010.



ARSIMI FILLOR NËNTËVJEÇAR



GJUHË RUSE

PROGRAMI  
MËSIMOR

Në bazë të nenit 55 paragrafit 1 nga Ligji për organizimin e punës së organeve të drejtorisë shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02 dhe 82/08) dhe neni 25 paragrafi 2 të Ligjit për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 103/08 dhe 33/2010) ministri i Arsimit dhe Shkencës e miratoi programin mësimor për lëndën *gjuhë ruse* për klasën e VI në arsimin fillor nëntëvjeçar.

# 1. HYRJE

## Vendi i lëndës në planin mësimor

### Përshkrimi dhe natyra e lëndës

Secili lloj i integritit më të gjerë në strukturat evropiane nënkupton kuadro të arsimuara mire të cilët njohin dhe flasin gjuhë të huaj. Para shoqërisë tone qëndron detyrë e madhe – arritja e idealit në Këshillit të Evropës për multigjuhësisë, sipas të cilit si minimum nënkuptohet njohja e mire e dy gjuhëve të huaja.

Gjatë studimit të gjuhës së huaj nxënësit formohen si personalitete të pavarura, e zhvillojnë vetëbesimin, pavarësinë, kreativitetin. E ndërtojnë motivimin e shprehive të punës dhe aftësive, përgatitjen për bashkëpunim, komunikim, tolerance, punë ekipore. Tek nxënësit ndërtohet kultura e sjelljes dhe respekti i bashkëbiseduesit, sjellja e mire në shkollë, familje, respekti i obligimeve shkollore, ndjenja e saktësisë dhe kujdesi i shoqërisë.

Gjuha ruse është gjuhë sllovene me kulture të pasur dhe traditë shken-core me të cilën flasin rreth 200 milion njerëz. Afërsia me gjuhët sllovene e lehtëson të kuptuarit e gjuhës ruse si gjuhë e huaj, e shkurton procedure për zhvillimin e aftësisë për dëgjim dhe mundëson që më shpejtë të zhvillohet aftësia e të folurit. Në kohën më të re gjuha ruse me sukses e tejkalon rrugën në shkollat në Evropë. Gjatë përpilimit të programit shfrytëzohen njohuritë nga realizimi i programeve mësimore të deritanishme nga gjuha ruse si gjuhë e pare dhe e dytë.

Në planin mësimor për arsimin fillor nëntëvjeçarë i është dhënë vend i posaçëm gjuhëve të huaja për shkak të faktit se në kuadër të globalizimit përshpejtohen ndryshimet ndërcivilizuese në të gjithë segmentet në jetesën shoqërore (ekonomike – politike, kulturore, arsimore etj) me çka imponohet nevoja e multigjuhësisë, çka është intencioni i konceptit të ri. Nga këto arsye mësimi i gjuhës së huaj të pare fillon që nga mosha

gjashtëvjeçare (klasa e I), ndërsa në moshën 11 vjeçe (IV) mësohet gjuha e huaj e dytë.

*Titulli i lëndës: gjuha ruse*

*Fondi javor, gjegjësisht fondi vjetor i orëve: 2/72*

*Statusi i lëndës: i detyrueshëm/gjuha e huaj e dytë*

## 2. QËLLIMET E PËRGJITHSHME PËR PERIUdhËN ZHVILLIMORE

Mësimi/studimi i gjuhës ruse në këtë nivel bazohet në këto qëllime themelore vijuese:

- nxënësi/nxënësjja të aftësohen për komunikim me tjerët, respektin e shumëgjuhësisë dhe pasurimin e kulturës së përgjithshme dhe kulturës gjuhësore;
- të formojë raport kritik ndaj kulturës personale dhe kulturave tjera dhe të aftësohet për respektin e dallimeve, të drejtave të njeriut, kulturave tjera dhe traditave;
- të stimulohet mësimi i gjuhës ruse, të zhvillohet interesi ndaj vendeve ku flitet gjuha adekuate për shkak të grumbullimit të informatave nga burimet e ndryshme të asaj gjuhe dhe zhvillimi i lidhjeve ndërkulturore.

## 3. QËLLIMET SPECIFIKE TË MËSIMIT TË GJUHËS RUSE

Nxënësi/nxënësjja

- të formojë dhe të zhvillojë kompetenca gjuhësore, komunikative, interkulturore për mësimin e gjuhës së huaj të dytë;
- të zhvillojë aftësi për ndërlidhjen e njohurive të arritura nga gjuha e huaj e parë, gjuha amtare dhe lëndët tjera gjatë mësimin të gjuhës së huaj të dytë;
- të formojë shprehje elementare dhe njohuri për dëgjim, të folur, lexim dhe të shkruar përmes sistemit të ndërtuar nga njohuritë e njësive gjuhësore dhe fjalive, fonetike, drejtshkrimore, leksikore dhe gramatikore;
- të zhvillojë aftësi për të mësuarit e pavarur dhe vetëvlerësimin sipas kornizës së përbashkët referente (Portfolio).

## 4. QËLLIMET KONKRETE

Qëllimet	Përmbajtjet	Shembujt	Aktivitetet dhe metodat
<p><b>Dëgjimi me kuptim</b></p> <p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të njeh dhe përkufizojë modele themelore të intonacionit, leksikonu internacionale të shoqëruara me tinguj dhe zëra;</li> <li>- të kuptojë pyetje dhe udhëzime të thjeshta në kuadër të procesit mësimor dhe të reagojë në mënyrë adekuate;</li> <li>- t'i kuptojë elementet ekstralinguistike (gjestet dhe mimika);</li> <li>- të kuptojë përshkrime të thjeshta për veta, situata ose vende;</li> <li>- ta kuptojë globalisht përmbajtjen e rrëfimit të shkurtër, tregimit ose dialogut;</li> <li>- të kuptojë në situata të njohura informata në rrëfim të shkurtër/tekst në gjuhën standarde ruse;</li> <li>- të adaptohet në shqiptimin dhe intonacionin e gjuhës amtare;</li> <li>- të fillojë të ndërtojë strategjinë personale për dëgjim me kuptim.</li> </ul>	<p><b>1. Unë dhe tjerët</b> - Emri, mosha, gjinia, nacionaliteti, familja ime, nxënësit tjerë, shokët</p> <p><b>2. Bota ime</b> - Shtëpia, shkolla, klasa, gjësende të shkollës, ngjyrat</p> <p><b>3. Trupi im</b> - Pjesët e trupit, pamja fizike, veshja, ngjyrat</p> <p><b>4. Koha e lirë</b> - Hobi, sporti, lojërat, muzika, kinemaja, Interneti</p> <p><b>5. Natyra</b> - Kafshët, bimët</p> <p><b>6. Kalendari</b> - Ditët e javës, muajt, stinët e vitit, festat, ora</p> <p><b>7. Rrumbullakimi</b> - Nocionet themelore gjeografike: vendi, qyteti, fshati, mjetet transportuese</p> <p>Në kuadër të temave të përcaktuara nxënësit duhet të fitojnë njohuri nga jeta sociokulturore e moshatarëve të tij nga Rusia përmes autentikes: - tregime, vjersha, poezi, lojëra, festa, zakone, tradita; t'i pasurojnë njohuritë për kulturën individuale dhe ekzistimin.</p>	<p><u>Грамматика</u> Письмо и орфография Русский алфавит. Написание и произношение.</p> <p><u>Фонетика</u> Сравнение русской фонетической системы с фонемами родного языка. Словесное ударение. Произношение ударных и безударных гласных: <b>ы, э</b> (оппозиция <b>и и ы, е и э</b>); <b>е, и</b> смягчение предшествующих согл.; <b>а, о, я</b>, редукция и изменения в безударной позиции; <b>ю, ё</b> (оппозиция <b>у и ю, е, о, ё</b>).</p> <p>Произношение твердых и мягких согласных: <b>й, щ</b> (оппозиция <b>и и й, ш и щ</b>); <b>ж, ш, ц, ч, щ</b>. Произношение <b>г</b> в окончании – <b>ого,-его; гк, гч</b> - легко, легче, чт, чн - что, конечно. Оглушение звонких согласных в конце слова: <i>клуб, рог, ложь</i>. Оглушение и озвончение согласных, парных по звонкости глухости внутри слова: <i>низко, свет, просьба</i>.</p>	<p><b>Aktivitet e llojit:</b></p> <p><i>Dëgjimi:</i> - audio/videoinçizime; - e folmja e mësimdhënësit;</p> <p><i>identifikimi:</i> - grafema; - tinguj; - fjalë; - pjesë të fjalive.</p> <p><b>Ushtrime me multi zgjedhje:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- Plotësimi, festat në fjali, tabelat, plotësimi i fjalive sipas tekstit të dëgjuar;</li> <li>- Reagimi me gjeste;</li> <li>- Ndërlidhja e fotografive me tekstin;</li> <li>- Përdorimi i mjeteve bashkëkohore didaktike (CD, DVD, Internet).</li> </ul>

Qëllimet	Përmbajtjet	Shembujt	Aktivitetet dhe metodat
<p><b>Të folurit</b>  <b>Shprehja gojore</b>  - të emëroj gjësende dhe dukuri nga mjedisi i drejtpërdrejtë;  - të riprodhojë fjali të thjeshta, numëratore, vjersha etj;  - të riprodhojë fjali të thjeshta dhe të zhvillojë biseda elementare me tema të njohura;  - të jep përshkrime të thjeshta për persona, situata dhe vende nga mjedisi i drejtpërdrejtë duke përdorur vokabular të njohur;  - të bëjë rrëfime të shkurtra monologë kur flet për ngjarje të tashme dhe të kaluara.</p> <p><b>Interaksioni i të folurit</b>  Nxënësi/nxënësja:  - të merr pjesë në situata të thjeshta të të folurit me tema të njohura nga mjedisi i drejtpërdrejtë, duke përdorur mjete të thjeshta gjuhësore;  - të reagojë në mënyrë adekuate jo verbale në udhëzimet e dhëna nga mësimdhënësi;  - të përgjigjet pyetjeve të thjeshta që kanë të bëjnë me tema të njohura;  - të parashtrijë pyetje të shkurtra për tema të njohura;  - ta përshtat interaksionin e kushteve të detyrës/situatës së dhënë komunikuese.</p>	<p><b>Nxënësit duhet ta përvetësojnë realizimin e modeleve vijuese komunikuese:</b>  Përshëndetja  Prezantimi i vetvetes dhe personat tjerë  Falënderimi  Të shprehurit e dëshirave  Të shprehurit e lutjeve  Falja  Uresa  Ftesa (pranimi dhe refuzimi)</p> <p>Të shprehurit e mendimit, qëndrimi</p> <p>Kërkesa/dhënia e informatës për dikë ose diçka.</p>	<p>Произношение ь в середине и в конце слова. Произношение разделительных ь и ы</p> <p><u>Морфология</u>  Имя существительное.  Род, число, падеж.  Существительные: мужского рода на согласный (тверд.мягк); сред. р. на –о,-е;  женск. р. на –а (я).  Винительный и предложный падеж с предлогами в и на.  Винительный падеж в функции прямого дополнения.  Родительный падеж с предлогом у.</p> <p><u>Имя прилагательное</u>  Род и число. Мужской, женский и средний род, единственного и множественного числа.</p> <p><u>Имя числительное</u>  Род, число. Правписание и произношение числительных от 1 до 100. Порядковые числительные до 10. Родительный падеж ед. и мн.числа для обозначения времени по часам и датам.</p> <p><u>Местоимение</u>  Род, лицо, число.</p>	<p><b>Rekomandimet didaktike</b>  Mësimdhënësi duhet ta nxit nxënësin/nxënësen:  - Të jep paragjykime për kuptimin e fjalës së veçantë, dëshmi ose tekst duke zbatuar njohuritë ekzistuese, kontekstin dhe strategjitë tjera për të kuptuar.</p> <p>- Me kontrollin e të kuptuarit duhet të përcaktohet saktësia e supozimeve.</p> <p>- të zbulojë dhe zhvillojë strategji individuale të të kuptuarit.</p> <p><b>Aktivitetet e llojit:</b>  - përsëritja e tingujve, fjalë, fjali të shkurtra sipas modelit të dhënë;  - krijimi i rrëfimeve të shkurtra;  - përshkrimi, recitimi, këndimi, shpjegimi sipas fotografive, video materiale etj;  - leximi i zëshëm sipas modelit të zëshëm.</p>

Qëllimet	Përmbajtjet	Shembujt	Aktivitetet dhe metodat
<p><b>Leximi</b></p> <p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të kuptojë udhëzimet në kuadër të orës mësimore në tekstet shkollore dhe materialet tjera ndihmëse;</li> <li>- të njeh shembujt e mësuar përmes dëgjimit në formën e shkruar;</li> <li>- të lexojë dhe kuptojë fjali të thjeshta dhe tekste të shkurtra me tematikë të përditshme;</li> <li>- të gjen informata konkrete në materiale të thjeshta, të përditshme, reklama, prospekte, katalogë, meny, rendin e vozitjes;</li> <li>- ta kuptojë përmbajtjen e ftesave të thjeshta, panoramave ose letra të shkurtra miqësore;</li> <li>- të njeh disa karakteristika apo veçori sociokulturore;</li> <li>- të ndërtojë gradualisht strategji individuale për të kuptuarit gjatë leximit.</li> </ul> <p><b>Të shkruarit</b></p> <p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- të shkruaj porosi të shkurtër (ftesë, letër të shkurtër mikut, panoramë, përshkrim të shkurtër);</li> <li>- të plotësojë formularë të thjeshtë me të dhëna biografike;</li> <li>- të shkruaj lexueshëm dhe qartë;</li> <li>- të shfrytëzojë mjete elementare gjuhësore, drejtshkrim dhe përdorimin e shen-</li> </ul>		<p>Личные местоимения (именительный и родительный падеж) Вопросительные местоимения кто, что, какой, чей. Притяжательные местоимения его, е, их. Указательные местоимения этот, тот.</p> <p><u>Глагол</u> Лицо, время, спряжение. Инфинитив; настоящее время (I и II спряжение); прошедшее время; будущее сложное время. Повелительное наклонение (2л.ед. и мн. число). Глаголы движения (идти-ходить, ехать-ездить).</p> <p><u>Наречие</u> Времени, места, и образа действия.</p> <p><u>Предлоги</u> у, в, на, с, о</p> <p><u>Союзы</u> и, но, или</p> <p><u>Синтаксис</u> Простые и распростра-</p>	<p><b>Aktivitetet e llojit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- pjesëmarrje në situata të shkurtra komunikuese dhe dramatizime, gjegjësisht parashtrimi i pyetjeve dhe përgjigja e tyre.</li> </ul> <p><b>Rekomandimet didaktike</b></p> <p>Mësimdhënësi duhet të nxit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>-nxënësin/nxënësen t'i zbatojë mjetet e përvetësuara gjuhësore komunikuese;</li> <li>- punën individuale dhe punën në grupe të vogla;</li> <li>- nxënësi/nxënësja t'i zbatojë mjetet e përvetësuara gjuhësore dhe komunikuese;</li> <li>- puna individuale dhe puna në grupet e vogla;</li> <li>- nxënësi/nxënësja ta merr fjalën;</li> <li>- kreativiteti tek nxënësit;</li> <li>- krijimi i atmosferës së këndshme për punën në orë.</li> </ul> <p><b>Aktivitetet e llojit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- identifikimi i grafemave të caktuara në fjali;</li> <li>- leximi i tregimeve;</li> <li>- përfundimi i fjalive;</li> <li>- plotësimi dhe nënvizimi i fjalëve dhe fjalive;</li> <li>- zgjidhja e detyrave saktë/pasaktë ose zgjedhje e më shumë gjymtyrësh;</li> <li>- transformimi i fjalive;</li> <li>- transferim i informatave me pasqyrë grafike etj;</li> <li>- bashkimi i fjalive;</li> <li>- ndërlihdhja e fotografive me dialogë të shkurtra, tekst;</li> <li>- radhitja e tekstit sipas renditjes logjike;</li> <li>- dhënia e titujve në pjesët e tekstit ose tekst;</li> <li>- njohja e llojit të tekstit;</li> <li>- pyetje të hapura.</li> </ul>

Qëllimet	Përmbajtjet	Shembujt	Aktivitetet dhe metodat
<p>jave të pikësimit të cilët nuk e pengojnë komunikimin; - të fillojë të ndërtojë strategji individuale për mbikëqyrjen e shprehjes me shkrim të gjuhës ruse.</p>		<p>ненные предложения. Повествовательные, во-просительные, отрицательные. <u>Лексика</u> Основной лексический минимум состоит из приблизительно 500 лексических единиц активного фонда (слова, словосочетания, выражения, фразеологизмы итд.), при помощи которого может реализоваться коммуникация по заданным темам и около 100 единиц пассивного фонда (напутствия, объяснения, предупреждения)</p>	<p><b>Rekomandime didaktike</b></p> <p>Mësimdhënësi duhet të zbatojë:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- udhëzime të qarta, të shkurtra dhe të kuptueshme;</li> <li>- puna individuale dhe puna në grupe të vogla dhe të mëdha;</li> <li>- aktivitetet përmes lojës;</li> <li>- mjetet mbikëqyrëse.</li> </ul> <p><b>Aktivitete të llojit:</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- plotësimi i fjalëve me shkronja të lëshuara;</li> <li>- përshkrimi i teksteve;</li> <li>- plotësimi i fjalëkryqit;</li> <li>- të shkruarit e fjalëve sipas fotografive;</li> <li>- shkrimi i letrave miqësore;</li> <li>- plotësimi i formularëve;</li> <li>- përfundimi i fjalive apo teksti i shkurtër;</li> <li>- renditja sipas radhitjes logjike të ofruar fjalë të përziera në fjali;</li> <li>- plotësimi i fjalive me fjalë që mungojnë;</li> <li>- kompletimi i dialogëve të hapura;</li> <li>- të shkruarit përmbajtje të shkurtër sipas fotografisë.</li> </ul> <p><b>Rekomandimet didaktike:</b></p> <p>Mësimdhënësi duhet të nxit:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>- nxënësi/nxënësja t'i zbatojë mjetet e përvetësuara gjuhësore dhe mjetet komunikative;</li> <li>- kreativitet tek nxënësit;</li> <li>- puna individuale dhe puna në grupe të vogla;</li> <li>- krijimi i atmosferës së këndshme për punë në orë.</li> </ul>

## 5. REKOMANDIMET DIDAKTIKE

**5.1. Udhëzime për lidhshmërinë ndërlëndore** (planifikimi integruar, gjegjësisht lidhshmëria e plotë përmbajtjesore ndërmjet lëndëve të ngjashme dhe lëmive)

Mësimi i gjuhës ruse paraqet mundësi për shfrytëzimin dhe krijimin e lidhjeve ndërmjet lëndëve që mësohen në klasën e VI, gjegjësisht i respektuar është parimi i ndërlidhjes ndërlëndore sipas raportit të qëllimeve dhe përmbajtjeve me theks të lidhjes integruese me përmbajtjet nga:

- gjuhë amtare, përmes njohurive të fituara dhe diturive nga ajo lëndë;
- gjuha e huaj e parë, përmes strategjive për mësim, puna me fjalorë, lidhjet sociokulturore;
- matematikë me nocionet për numrat natyror, data, format gjeometrike;
- histori me nocionet për shoqëri, festa, tradita;
- gjeografia me nocionet për kontinente, harta gjeografike, klima, rrugëtime;
- bazat e shkencave natyrore me nocionet për bimët, kafshët, ekologjinë;
- muzika – stilet e muzikës, mësimi i vjershave ruse;
- arsimit fizik dhe shëndetësor – llojet e sporteve, higjiena, shëndeti,
- arsimit figurativ – shkathtësi për të vizatuar në funksion të të kuptuarit etj.

Ekzistojnë edhe shembuj tjerë për korrelacion me lëndë tjera mësimore. Obligimi i mësimdhënësit është që t'i adaptojë nxënësit që në mënyrë të pavarur të mendojnë dhe ta gjen atë lidhje ndërmjet gjuhës ruse dhe lëndëve tjera.

### 5.2. Rekomandime për shfrytëzimin e fondit vjetor të orëve

Procesi i mësimi të gjuhës ruse zhvillohet përmes fondit javor dhe vjetor të orëve, përmes komponentëve që mësohen dhe të cilët i përbëjnë

shkathtësitë përfundimtare gjuhësore që nxënësi duhet t'i përvetësojë në fund të nivelit adekuat, megjithatë ata nuk mund të ndahen, gjegjësisht nuk mund të planifikohet numri i orëve sipas komponentëve të caktuara. Thënë më konkretisht në mësim këto komponentë nuk përpuhohen në veçanti dhe me numër kuantitativ të orëve ose sipas asaj radhitje siç janë dhënë në program, por të integruar në funksion të gjuhës gjegjësisht krijimi i kompetencave komunikative në situatat konkrete që gjegjësisht paraqet qëllim përfundimtar në program.

Qasja ndaj gramatikës është kognitive. Përmbajtjet gramatikore përpuhohen në kontekst, sipas rrugës induktive ndërsa rregullat gramatikore nuk duhet të mësohen dhe kontrollohen të izoluar, jashtë nga konteksti. Përmbajtjet duhet të jenë të integruara në tërësitë e parapara tematike.

Përmbajtjet e propozuara në programet thellohen secilin vit vijues.

### 5.3. Mjetet mësimore

- Sistemi i kompletuar i teksteve shkollore (libër i zgjedhur në nivel të shkollës për lëndën adekuate dhe i lejuar nga MASH, doracak për mësimdhënësin, fletore pune për nxënësin, CD, portfolio etj)
  - fjalor, enciklopedi, posterë;
  - revista të huaja për mësimdhënësin dhe nxënësit
- Kasetofon, kasete, kompjuter me qasje në Internet, CD rom, TV me TVSH.

Nevojitet që mësimdhënësi të mos kufizohet vetëm me kompletin e teksteve shkollore, por ai mundet dhe duhet të përgatit materiale plotësuese dhe të gjen informata dhe dokumente autentike nga burime të ndryshme, në funksion të realizimit të qëllimeve të parapara në mësim.

## 6. VLERËSIMI I TË ARRITURAVE TË NXËNËSVE

Kontrolli dhe vlerësimi i rezultateve të arritura është element shumë i rëndësishëm gjatë mësimit/mësimnxënies. Mësimdhënësi vazhdimisht duhet ta vëzhgojë punën e nxënësve dhe t'i nxit në përparimin e tyre, ndërsa vlerësimin duhet ta përshtat me metodat themelore për objektivitet dhe validitet. Gjatë vlerësimit të të arriturave të nxënësit në këtë nivel duhet t'ju mundësohet liri në të arriturat dhe shprehjet e qëllimeve konkrete komunikative. Gabimet e bëra dhe të lëshuara korrigjohen përmes shprehjes së formës së rregull. Më e preferuar është që mësimdhënësi t'ju ndihmojë nxënësve vetë t'i zbulojnë gabimet dhe të korrigjohen reciprokisht. Mësimdhënësi do të duhet t'i inkurajojë nxënësit. Me rëndësi të veçantë është që format e vlerësimit të jenë të llojllojshme dhe sistematike t'i përcjellin të arriturat e nxënësve në aktivitete të ndryshme. Gjatë vlerësimit të të arriturave të nxënësve në të shprehurit me shkrim dhe me gojë vëmendje duhet kushtuar ndaj evolucionit formativ me qëllim që mësimdhënësi dhe nxënësi të informohen për nivelin e njohurive dhe aftësive të arritura, që të mundet tejkalohen në kohë lëshimet eventuale në mësime dhe mësimnxënies. E rëndësishme është që mësimdhënësi sistematikisht ta kontrollojë nivelin e njohurive dhe shkathtësive të nxënësve, të zbatojë forma të ndryshme të vlerësimit dhe të shfrytëzojë kritere të veçanta gjatë formimit të notës.

Ai duhet ta përcjell raportin e nxënësit ndaj procesit mësimor dhe ta vlerësojë pjesëmarrjen e tij në aktivitetet e ndryshme:

- puna në orë (frontale, në grupe, nga dy, individuale);
- përpunimi i detyrave të shtëpisë;
- puna e nxënësit në projekte.

Të arriturat e nxënësve përcillen përmes *testeve periodike* me përmbajtje dhe kohëzgjatje të ndryshme. Përparësia duhet të jepet në ndërtimin e aftësive komunikative të nxënësit në kuadër të qëllimeve të pa-

rapara (psh., përpilimi i testit sipas fotografive/varg fotografish, shkruarja e letrës personale sipas elementeve të dhëna, ftesë, porosi e shkurtër, detyrë për vlerësimin e të kuptuarit ose teksti që është dëgjuar). Vendin e vet duhet ta gjejë edhe vlerësimet e njohurive të përvetësuar nga gramatika dhe leksiku me çka e kontrollojmë përvetësimin e strukturës gjuhësore të parapara në program.

Përkthimi nuk parashihet dhe nuk duhet të jetë mjet për vlerësimin e njohurive të nxënësve.

Diktimi shfrytëzohet si aktivitet ushtrues. Mund të ndërlihet edhe në kuadër të procesit të mësimnxënies.

Vlerësimet duhet të jenë të arsyetueshme dhe të argumentuara mirë para nxënësve, të kenë karakter kurrajues dhe ta motivojnë mësimnxënien e gjuhës ruse. Sipas Konceptit për arsimin dhe edukimin fillor nëntëvjeçarë në fund të klasës së VI përveç vlerësimit inter do të realizohet kontrollimi i të arriturave, por me teste të përgatitura standarde.

*Sipas kornizës evropiane të Përbashkët për gjuhët e huaja niveli i njohurive të nxënësve nga klasa e VI duhet të përputhet me njohuritë themelore në A1 nga kjo kornizë.*

## 7. KUSHTET HAPËSINORE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT MËSIMOR

Programi sa i përket kushteve hapësinore për realizim bazohet në Normativin për hapësirë, pajisje dhe në mjetet mësimore për klasën e IV të miratuar nga ministri i Arsimit.

Kushtet hapësinore dhe pajisja e klasave për realizim të suksesshëm të programit mësimor për klasën e VI duhet të jenë në përputhje me normativin e përgjithshëm për pajisjen për realizimin e programeve mësimore për klasën e VI

Rekomandohet, për shkak të kontaktit më të lehtë vizual ndërmjet nxënësve, që të dëgjojë më mirë çka flitet dhe nxënësi që është më larg të ketë pasqyrën e klasës, bankat të jenë të radhitura në këtë mënyrë: më tepër banka të afuara bashkë, variante të ndryshme të shkronjës „U” si dhe zhvendosja dhe grupimi i bankave sipas nevojës, varësisht nga aktivitetet e parapara

## 8. NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR

- Studimet e përfunduara nga gjuha ruse dhe letërsia- udhëzimi mësimor, VII<sup>1</sup>
- Studimet e përfunduara nga gjuha ruse dhe letërsia, VII<sup>1</sup>.
- Studime të përfunduara nga gjuha ruse dhe letërsia – drejtim tjetër dhe me marrjen e përgatitjes adekuate pedagogjike – psikologjike në fakultetet adekuate, VII<sup>1</sup>.

## 9. REZULTATE TË ARRITURA

Rezultatet e arritura përputhen me kolonën nr. 2 nga Programi mësimor, gjegjësisht nga qëllimet e parapara të viti mësimor, të cilët njëherë paraqesin nivele të njohurive të rezultateve të arritura tek nxënësit, të cilët duhet të përgjigjen në njohuritë në nivelin A1 nga korniza referenciale.

Programin mësimor lënda e *gjuhës ruse* për klasën e VI në arsimin fillor nëntëvjeçarë e solli ministri i Arsimit dhe Shkencës me vendim.. nr. 07-668/5 më 05.11.2010.

ARSIMI FILLOR NËNTËVJEÇAR

PROGRAMI  
MËSIMOR



MATEMATIKË

Në bazë të nenit 55 paragrafit 1 nga Ligji për organizimin e punës së organeve të udhëheqjes shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 58/00, 44/02 dhe 82/08) dhe neni 24 dhe 26 paragrafi 2 nga Ligji për arsimin fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 44/95, 24/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 63/04, 82/04, 55/05, 81/05, 113/05, 35/06, 70/06 dhe 51/07), ministri i Arsimit dhe Shkencës e miratoi Programin mësimor për lëndën *Matematikë* për klasën e VI në arsimin fillor nëntëvjeçar.

## 1. QËLLIMET E MËSIMIT NË KLASËN E VI

Nxënësi/nxënësjja:

- të dijë cilat bashkësi janë (jo)të barabarta, (jo)ekuivalente, (fundme, pafundme) dhe ti realizojë operacionet e bashkësive;
- ta kuptojë sistemin e dijë ndarjen e numrave natyrorë me 2,3,4,5 dhe 9 dhe këtë ta përdorë në detyra;
- të krahasojë dhe thjeshtësojë thyesën dhe të realizojë operacione me thyesa me emërues të njëjtë;
- të shndërrojë thyesa në numra dhjetorë dhe në përqindje dhe të kryejë operacione me numrat decimal;
- të dallojë kuptimet elementare (pika, drejtëza, rrafshi, largesa) nga nocionet e realizuara (gjysmëdrejtëza, drejtëza, këndi, shumëkëndëshi, rrethi, gjatësia);
- në mënyrë grafike të mbledh dhe zbret segmentin dhe grafikisht dhe në mënyrë aritmetike të mbledh dhe zbrit këndet;
- të matë masën, gjatësinë, temperaturën dhe syprinën e objekteve dhe gjësendeve, të masë kohën, të njeh masat për lëngjet;
- të dijë cili numër është emërtues dhe të shndërrojë numrat një emërtues në numra shumë emërtues dhe e kundërta;
- të kryejë operacione me numra emërtuar dhe të ketë njohuri elementare për vëllimin dhe njësitë matjen e vëllimit;
- të grumbullojë dhe paraqesë të dhënat, të bëjë analizë elementare, të hulumtojë dhe të zgjidh probleme në mënyra të ndryshme;
- të përdorë terminologji matematikore gjatë paraqitjes gojore dhe me shkrim;
- të zgjidh probleme dhe ta zhvillojë logjikën e të menduarit;
- të ketë qasje kritike ndaj punës personale dhe punës së të tjerëve;
- të mendojë dhe me përgjegjësi ti kryejë obligimet personale;
- ta përjetojë matematikën si përvojë e mirë;
- të shfrytëzojë numrave dekade, të realizojë operacione aritmetike me numra natyror;
- ta TIK në përmbajtjet e matematikës.

## 2. QËLLIMET KONKRETE

Tema 1: NUMRAT NATYRORË (N)			
Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
<p>Nxënësi/nxënësja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të formojë dhe të shkruajë bashkësi dhe nënbashkësitë në mënyra të ndryshme;</li> <li>të caktojë elementet e bashkësisë;</li> <li>të vërejë nënbashkësinë në bashkësinë e dhënë;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Bashkësia; mënyrat e paraqitjes (ose të shkruarit)</li> <li>Bashkësi të rëndomta (<math>A=B</math>) dhe bashkësi ekuivalente (<math>A\sim B</math>)</li> <li>Bashkësi të fundme.</li> <li>Unioni i bashkësive.</li> <li>Prerja e bashkësive,</li> <li>Dallimi i bashkësive</li> <li>Prodhimi i Dekartit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Numri i bashkësive (<math>\mathcal{D}(A)</math>)</li> <li>Nënbashkësitë (<math>\subseteq</math>)</li> <li>Nënbashkësitë e vërteta (<math>\subset</math>)</li> <li>Bashkësi e zbrazët (<math>\emptyset</math>)</li> <li>Bashkësi të barabarta</li> <li>Bashkësi ekuivalente (të njëjta në numër)</li> <li>Bashkësi fundme.</li> <li>Unioni i bashkësive (përs.)</li> <li>Prerja e bashkësive (përs..)</li> <li>Ndryshimi i bashkësive (përs.)</li> <li>Çift i radhitur</li> <li>Prodhimi i dekartit</li> </ul>	<p>Të përdoren simbole adekuate dhe të vërehen lidhjet ndërmjet përshkrimeve të bashkësive. Diagrami i Venit të përdoret edhe për sqarimin e mënyrave tjera të përshkrimit të bashkësive, më pas bashkësitë e barabarta dhe ato ekuivalente.</p> <p><u>Shembull:</u> bashkësia e grurit të një are; bashkësia numra natyror deri 1 000.</p> <p>Të përdoret Diagrami i Venit për sqarimin e ligjshmërive në operacionet e bashkësive..</p> <p>Fëmijët të aftësohen të përgjithësojnë:</p> <p><u>Shembull:</u> Nëse <math>A \cup B = \{1, 2, 3, 4\}</math> atëherë <math>3 \in A</math> ose <math>3 \in B</math></p> <p><u>Shembull:</u> <math>A \cap B = \{5, 6, 7, 9\}</math>, atëherë <math>6 \in A</math> dhe <math>6 \in B</math></p> <p><u>Psh.:</u> Cili numër është më i madh 5ose 8? [Përgjigja: 8]</p>


Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
<ul style="list-style-type: none"> <li>të sqarojë cilat bashkësi janë fundme, e cilat pafundme;</li> <li>ti përdorë nocionet: bashkësi, nën-bashkësi, unioni i bashkësive, prerja e bashkësive, ndryshimi i bashkësive, prodhimi i i Dekartit i bashkësive dhe ti shkruajë në mënyrë simbolike;</li> <li>ti paraqesë operacionet e bashkësive dhe drejtë ti përdorë shenjat përkatëse; <ul style="list-style-type: none"> <li>ta kuptojë kuptimin e fjalëve dhe, ose.</li> </ul> </li> <li>ti radhisë numrat natyrorë në drejtëz numerike dhe të lexojë numrat natyrorë më të mëdhenj se 1 000 000</li> <li>të dijë se 1 është numër më i vogël natyrorë, 0 nuk është numër natyrorë dhe se nuk ekziston numër më i madh natyror;</li> <li>të rumbullakojë numrat natyrorë më të mëdhenj se një milion të dhjetëshëve, qindëshëve dhe mijëshëve;</li> <li>të dallojë shifrën nga numri;</li> <li>të caktojë klasat dhe pozicionet në numrin shumë shifrorë;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Bashkësia e numrave natyrorë; (No); bashkësi pafundme</li> <li>Radhitja e numrave natyrorë;</li> <li>leximi i numrave natyrorë më të mëdhenj se 1 000 000</li> <li>Rrumbullakimi i numrave natyrorë të dhjetëshëve, qindëshëve dhe mijëshëve;</li> <li>Sistemi i numrave dekad</li> <li>Mbledhja e numrave natyrorë vetitë e mbledhjes</li> <li>Zbritja e numrave natyrorë</li> <li>Shumëzimi i numrave natyrorë</li> <li>Vetitë e shumëzimit</li> <li>Pjesëtimi në bashkësi të numrave natyrorë;</li> <li>Pjesëtimi me mbetje</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>milion</li> <li>miliardë,</li> <li>bilion,</li> <li>trilion.</li> <li>Sistemi i numrave dekad</li> <li>klasa</li> <li>pozicioni</li> <li>Operacioni aritmetik</li> <li>Ndarja e bashkësive në raport me mbledhjen dhe zbritjen</li> <li>shkalla e numrit natyror</li> </ul>	<p>Nga numrat 5 dhe 8 cili numër është më i madh? (Përgjigja: 9)</p> <p><u>Shembull: Vizato gjysmëdrejtëz numerike dhe caktoje me 0, 10, 20, ..., 100. Vlerëso gjendjen e numrit 67 në atë drejtëz numerike.</u></p> <p><u>Shembull: Cila nga shenjat „=ose&gt; duhet të qëndrojë në rreth që të jetë e saktë? 322 ○ 297</u></p> <p><u>Shembull: Lexoje me zë numrin 345 623 124</u></p> <p><u>Shembull: Vallë numri 4678 është mi afërt deri te nr. 4600 ose deri 4700?</u></p> <p><u>Shembull: Shkruaje numrin i cili ka 3 treqind mijë, 2 dhjetë mijëshe 7 mijë 5 qindëshe dhe 6 njësi;</u></p> <p><u>Shembull: Shoku yt thotë se <math>25346 + 6978 = 5524</math>. Pa zgjidh detyrën sqaro pse mendon se përgjigja është e gabuar?</u></p> <p>Zgjidhen detyra tekstuale në të cilat përdoren nocionet: shuma, ndryshimi, prodhimi, herësi, mbledhësi, zbritësi, shumëzuesi, pjesëtuesi dhe i pjesëtueshmi.</p>

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
<ul style="list-style-type: none"> <li>• ti realizojë katër operacionet aritmetike me numra natyrorë;</li> <li>• të vlerësojë rezultatit nga mbledhja, zbritja, nga shumëzimi dhe pjesëtimi;</li> <li>• të shkruajë prodhimin e bashkësive të barabarta sipas llojit të shkallës;</li> <li>• të caktojë mbetjen gjatë pjesëtimit në bashkësinë e numrave natyrorë dhe këtë ta përdorë në detyra</li> <li>• të dijë si varen shuma, ndryshimi, prodhimi dhe herësi i numrave natyrorë nga ndryshimi i komponentëve;</li> <li>• të llogarisë vlerën e shprehjes numerike;</li> <li>• të kryejë më shumë operacione aritmetike duke respektuar radhitjen e operacioneve;</li> <li>• të përdorë kalkulator gjatë caktimit të shumë, ndryshimit, prodhimit ose herësit të numrave „të mëdhenj”;</li> <li>• të zgjidh barazimet me përdorimin e operacioneve të thjeshta aritmetike dhe karakteristikat e tyre;</li> <li>• ti dinë dhe ti përdorin shenjat për pjesëtim me : 2, 5, 3, 9 dhe 4</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Varësia e shumë nga ndryshimi i mbledhësve;</li> <li>• Varësia e herësit nga ndryshimi i pjesëtueshmit dhe pjesëtuesit;</li> <li>• Shprehje numerike</li> <li>• Radhitja e operacioneve aritmetike</li> <li>• Zgjidhja e barazimeve me përdorimin e karakteristikave e operacioneve elementare aritmetike</li> <li>• Plotëpjestueshmëria e numrave natyrorë</li> <li>• Indicet ose kriteret për plotëpjestueshmërinë me: 2, 5, 3, 9 dhe 4</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Vlera e shprehjes numerike</li> <li>• Madhësia e panjohur (në barazim)</li> <li>• Pjesëtuesi;</li> <li>• Shumëfishi</li> </ul>	<p>Shembuj <math>65 + 127 = 192</math>  <math>(65+8) + 127 = 200 = \underline{192+8}</math>  <math>459 - 142 = 317</math>  <math>(459 - 6) - 142 = 311 = \underline{317 - 6}</math>  <math>459 - (142-5) = 323 = \underline{317 + 5}</math>  <math>522:9 = 58</math>  <math>(522 \cdot 3) : 9 = 174 = \underline{58 \cdot 3}</math>  <math>522:(9 \cdot 2) = 29 = \underline{58:2}</math></p> <p>Shembuj  <math>\frac{3 \cdot (7+2)}{}</math> = 27  Vlera e paraqitjes numerike</p> <p>Shembuj2: : hyn në shitore me 90 denarë dhe blenë 3 lapsa, secili nga 20 denarë. Shkruaj shprehjen e shumë në denarë (x) që do të mbetet e paharxhuar. Më pas shëno barazimin dhe zgjidhe.  Shembull: Numri 3465 është i pjesëtueshëm me 9 sepse shuma <math>3+4+6+5 (= 18)</math> është i pjesëtueshëm me 9.</p>





<sup>1</sup> Shenja është pohim i cili tregon kusht të mjaftueshëm për ekzistimin e ndonjë pohimi. Psh.1. Shenja për pjesëtim me 5 thotë: nëse shifra e fundit e ndonjë numri është 0 ose 5, atëherë ky numër është pjesëtueshëm me 5. Shembull 2: Gjatë realizimit të kësaj programe në vend të fjalisë të llojit: kusht i mjaftueshëm që një numër të jetë

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
<ul style="list-style-type: none"> <li>• të caktojë pjesëtuesit dhe shumëfishin e numrave natyrorë;</li> <li>• të zbërthejë numrin natyror të përbërë në shumëzuesit e thjeshtë;</li> <li>• të caktojë se vallë shuma, ndryshimi, përkatësisht prodhimi i numrave natyrorë është i pjesëtueshëm me numër natyror;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numrat e thjeshtë dhe të përbërë</li> <li>• Pjesëtues të përbashkët (pp) dhe shumëfish të përbashkët (shp) i numrave natyrorë</li> <li>• Pjesëtues më i madh i përbashkët (pmp) dhe shumëfish më i vogël i përbashkët (shvp)</li> <li>• Shndërrimi i numrit të përbërë i shumëzuesve të thjeshtë</li> <li>• Pjesëtimi i shumës, ndryshimi dhe prodhimi me numra natyrorë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Numër i thjeshtë;</li> <li>• Numër i përbërë;</li> <li>• Pjesëtues të përbashkët;</li> <li>• Pjesëtues më i madh i përbashkët;</li> <li>• Shumëfishi i përbashkët</li> <li>• Shumëfishi më i vogël i përbashkët.</li> </ul>	<p>Përvetësohen teknika për caktimin e ShP, ShPV, PP, dhe PMP e numrave natyror.</p> <p>Identifikohen dhe përshkruhen numrat e thjeshtë dhe të përbërë.</p>

**TEMA 2: TRUPAT GJEOMETRIK NË RRAFSH**

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
<p>Nxënësi/nxënësja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ti njohë dhe përdorë raportet në detyrë: shtrihet në, nuk shtrihet në, është paralele dhe të përdorë simbolikën përkatëse;</li> <li>• ti kuptojë pozitat reciproke të pikës dhe drejtëzës dhe në dy drejtëza gjatë zgjidhjes së problemit nga praktika;</li> <li>• të dijë ti lidhë nocionet pikë dhe drejtëz me gjysmëdrejtëz, segment, vijën e thyer dhe nocionin largesën me nocionin gjatësi;</li> <li>• grafikisht dhe aritmetik të mbledh dhe zbrit segmente;</li> <li>• ti dijë nocionet: vijë rrethore, rreth, rreze, diametër, tetivë, dhe të vizatojë vijë rrethore me rreze të dhënë (me kompas);</li> <li>• ti vështrojë pozitat reciproke të vijës rrethore dhe: pikës; drejtëzës; vijës rrethore;</li> <li>• ti dijë kuptimet gjysmërrafsh dhe kënd;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pika dhe drejtëza. Vetitë themelore të drejtëzës;</li> <li>• Pozita reciproke e dy drejtëzave</li> <li>• Largesia midis dy pikave;</li> <li>• Gjysmëdrejtëza dhe segmenti</li> <li>• Gjatësia e segmentit</li> <li>• Vija e thyer</li> <li>• Konceptet themelore dhe të nxjerra</li> <li>• Mbledhje dhe zbritje grafike e segmenteve</li> <li>• Vija rrethore dhe rrethi;</li> <li>• Pozita reciproke e: vijës rrethore dhe pikës: vijës rrethore dhe drejtëzës</li> <li>• Pozita reciproke i dy vijave rrethore</li> <li>• Nocioni për këndin</li> <li>• Këndet fqinje, të puqët dhe të kryqëzuara</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pika (jo) kolineare</li> <li>• Drejtëza paralele (përs).</li> <li>• Distanca, largesa</li> <li>• Nocioni elementar, nocioni realizues</li> <li>• Pika fillestare e gjysmëdrejtëzës</li> <li>• Pika e mesme e segmentit</li> <li>• Gjatësia e segmentit</li> <li>• Segmente të barabarta (të përputhura)</li> <li>• Tetiva ose korda</li> <li>• Segmenti</li> <li>• Tangjenta</li> <li>• Harku rrethor</li> <li>• Gjysmërrafshi</li> <li>• Këndi (jo) konveks</li> <li>• Këndet fqinje</li> </ul>	<p>Shembull: Shërbeu me shenjat në dyshemenë e sallës së edukatës fizike, për të identifikuar dy çifte që janë paralele. Vendos litra përmes vijave paralele. Në gjeotabelë paraqesin segmente, segmente të rëndomta, vija të thyera.</p> <p><u>Shembull:</u> nëse <math>\overline{AB} = 8cm, \overline{CD} = 16cm,</math> atëherë <math>\overline{AB} + \overline{CD} = 24cm,</math></p>  <p>AB - korda, OR - radiusi harku AB MN - rreze</p>

<sup>2</sup>Gjeotabela e katrorit, trekëndëshit ose lloj tjetër të rrjetit në të cilin në tehet e katrorit, trekëndëshit... ka thumba të farkuar dhe mund të bëhen figura në rrafsh me ndihmën e Ilastikut ose perit.

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
<ul style="list-style-type: none"> <li>• ti dijë nocionet gjysmërrafsh dhe kënd;</li> <li>• të dijë cili kënd është konveks e cili nuk është jokonveks;</li> <li>• ti dijë llojet e këndeve sipas madhësisë (këndi zero, i ngushtë, drejtë, këndi gjerë, rrafshët, kënd i plotë);</li> <li>• të vizatojë simetralen e segmentit dhe simetralen e këndit;</li> </ul> <p>•të vizatojë normalen ose pingualen e drejtëzës dhe të caktojë largesën nga pika deri te drejtëza;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• në mënyrë grafike dhe aritmetike të mbledh dhe zbrit kënde;</li> <li>• ti dijë kuptimet: shumëkëndësh, shumëkëndësh konveks, llojet e shumëkëndëshave dhe perimetrin e shumëkëndëshave dhe ti zbatojë në detyra nga përditshmëria;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Matja e këndit (me aglomer)</li> <li>• Llojet e këndeve sipas madhësisë</li> <li>• Këndi qendror</li> <li>• Të vizatuarit e këndit të barabartë me këndin e dhënë</li> <li>• Kënde komplementare dhe suplementare</li> <li>• Simetria e segmentit dhe simetria e këndit</li> <li>• Normalja e drejtëzës</li> <li>• Largesja nga pika deri drejtëza</li> <li>• Mbledhja grafike dhe zbritja grafike e këndeve</li> <li>• Mbledhja aritmetike dhe zbritja aritmetike e këndeve</li> <li>• Shumëkëndëshi.</li> <li>• Shumëkëndëshi konveks</li> <li>• Llojet e shumëkëndëshit</li> <li>• Perimetri i shumëkëndëshit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Këndet të puqët</li> <li>• Këndet e kryqëzuara</li> <li>• Këndi i shtrirë</li> <li>• Këndi i plotë</li> <li>• Këndi qendror</li> <li>• Këndet komplementare</li> <li>• Këndet suplementare</li> <li>• Simetralja e segmentit</li> <li>• Simetralja e këndit</li> <li>• Normalja e drejtëzës</li> <li>• Largesja nga pika deri te drejtëza</li> </ul> <p>• Vija poligonale</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Shumëkëndëshi (jo) konveks</li> <li>• Perimetri i shumëkëndëshit</li> </ul>	<div style="display: flex; justify-content: space-around; align-items: center;"> <div style="text-align: center;">  <p>Këndi jokonveks</p> </div> <div style="text-align: center;">  <p>Këndi konveks</p> </div> </div> <p>Shembulli: Vizato dy gjysmëdrejtëza të cilat fillojnë nga pika e njëjtë fillestare dhe krijojnë kënd të gjerë.</p> <p>Në gjeotabelë paraqesin kënde fqinje, kënde të kryqëzuara, kënde të puqët... Vizatojnë simetrinë e segmentit dhe simetrinë e këndit dhe normalen pingulen e drejtëzës me matje.</p> <p><u>Shembull:</u>  <math>34^{\circ}27'15'' - 12^{\circ}21'06'' = 22^{\circ}05'09''</math></p> <div style="display: flex; justify-content: space-around; align-items: center;"> <div style="text-align: center;">  </div> <div style="text-align: center;">  </div> </div> <p style="text-align: center;">Shumëkëndëshi jokonveks dhe konveks</p>

### TEMA 3: THYSAT, NUMRAT DHJETORË

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
<p>Nxënësi/nxënësjja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ta përdorë rëndësinë e numëruesit, emëruesit dhe vijës së thyesës;</li> <li>• ti njohë llojet e thyesave;</li> <li>• të shkruajë numrin natyrorë në lloj të thyesës;</li> <li>• të paraqesë thyesë më të madhe se 1 në numër të përzier dhe e kundërta;</li> <li>• të paraqesë thyesë në drejtëz numerike;</li> <li>• ta kontrollojë barabarësinë e dy drejtëzave;</li> <li>• të zgjerojë dhe thjeshtësojë thyesa;</li> <li>• ti kuptojë nocionet: thyesa decimale, numër decimale, pjesë decimale, pjesë dhe pjesë dhjetore e numrit, vendi decimale, decimale;</li> <li>• të bëjë vlerësimin e rezultatis nga mbledhja ose nga zbritja.</li> <li>• të shumëzojë dhe pjesëtojë numër decimale me njësi dekadë;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Thyestat. Të lexuarit dhe të shkruarit</li> <li>• Llojet e thyesave</li> <li>• Paraqitja e thyesave në drejtëz numerike</li> <li>• Barazia e thyesave</li> <li>• Mbledhja dhe zbritja e thyesave me emërues të barabartë (përs.)</li> <li>• Zgjerimi dhe thjeshtësimi i thyesave</li> <li>• Thyesa decimale dhe numri decimale</li> <li>• Vetitë e numrit decimale</li> <li>• Paraqitja e drejtëzës numerike</li> <li>• Krahasimi</li> <li>• Mbledhja dhe zbritja e :             <ul style="list-style-type: none"> <li>- numrit decimale dhe natyror,</li> <li>- numrave decimale.</li> </ul> </li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Thyesa më e vogël se 1</li> <li>• Thyesa e drejtë (e pastër)</li> <li>• Thyesa më e madhe se 1</li> <li>• Thyesa jo e drejtë (jo e pastër)</li> <li>• Numër i përzier</li> <li>• Thyesa të barabarta             <ul style="list-style-type: none"> <li>- zgjerimi (i thyesës)</li> <li>- thjeshtësimi (i thyesës)</li> <li>- thyesa që nuk thjeshtohet</li> </ul> </li> <li>• Thyesa dhjetore</li> <li>• Numri dhjetore</li> <li>• Pjesë dhjetore</li> <li>• Shuma e numrave dhjetorë</li> <li>• Ndryshimi i numrave dhjetorë</li> </ul>	<p>Rëndësia e numëruesit, emëruesit dhe vijës së thyesës</p> <p>Secili numër është numër decimale: 3, 5, 123, 0,123, 56, 2,04,... Të shkruhen numrat natyrorë si numra decimale, për ti kuptuar numrat decimale dhe thyestat decimale.</p> <p><u>Shembull:</u>  <math>3,23045 + 2,006002 = 5,236452</math></p>

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
<ul style="list-style-type: none"> <li>• të shumëzojë numra decimal;</li> <li>• të pjesëtojë numra decimal me numër natyror dhe me numër decimal;</li> <li>• të shndërrojë thyesën në numër decimal dhe të shkruajë numrin decimal në lloj të thyesës decimale;</li> <li>• të dallojë numrin decimal fundlm dhe të pa fundëm dhe nga numri decimal periodik;</li> <li>• të rrumbullakojë numrin decimal deri te numrat e dhënë decimal dhe ta vlerësojë saktësinë e rrumbullakimit.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shumëzimi i numrit decimal me: <ul style="list-style-type: none"> <li>- njësi dekadë</li> <li>- prodhimin e numrit natyror</li> <li>- numrin decimal</li> </ul> </li> <li>• Pjesëtimi i numrit decimal me: <ul style="list-style-type: none"> <li>- numër natyror</li> <li>- numër decimal</li> </ul> </li> <li>• Shndërrimi i thyesës në numër decimal</li> <li>• Numri decimal përfundimtar dhe jo përfundimtar</li> <li>• Numri decimal periodik</li> <li>• Rrumbullakimi i numrit decimal</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prodhiimi i numrave dhjetorë</li> <li>• Herësi i numrave dhjetorë</li> <li>• Numri decimal i fundëm</li> <li>• Numri decimal jo përfundimtar</li> <li>• Numri decimal periodik</li> </ul>	<p><u>Shembull:</u> Shembull: Vlerëso rezultatin e mbledhjes <math>0,72 + 0,8</math>. Vallë shuma është më e madhe se 1?</p> <p>Shembull: Rrugën prej 50 m mund ta vraposh për 6,73 sekonda. Rrumbullako kohën tuaj të dhjetëshes më të afërt.</p>

TEMA 4: MATJA

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
<p>Nxënësi/nxënësja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ti dijë njësitë matëse themelore për gjatësinë, masën, lëngun, kohën, temperaturën dhe syprinën, si dhe njësitë më të vogla dhe më të mëdha nga njësia themelore;</li> <li>• ta dijë njësinë matëse për vëllim dhe ta llogarisë vëllimin e kuadrit dhe kubit;</li> <li>• të shndërrojë numrat emërues ose emërtuar;</li> <li>• të mbledh dhe zbrit numrat emërues;</li> <li>• Të shumëzojë dhe pjesëtojë numra me numër emërues;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njësitë matëse për: gjatësi, masë, lëngje, kohë, temperaturë, syprinë dhe vëllim</li> <li>• Numrat e emërtuar</li> <li>• Shndërrimi i numrave njëemërues në numra shumëemërues dhe e kundërta (përveç njësive matëse për syprinë dhe vëllim)</li> <li>• Shndërrimi njësive matëse më të mëdha në më të vogla dhe e kundërta (përveç njësive matëse për syprinë dhe vëllim)</li> <li>• Mbledhja dhe zbritja e numrave emërues (përveç njësive matëse për syprinë dhe vëllim)</li> <li>• Shumëzimi dhe pjesëtimi i numrave emërues me jo emërues.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njësia matëse</li> <li>• Njësi matëse për gjatësinë, për masën, për lëngje, për kohën, për temperaturën, për syprinën dhe për vëllimin</li> <li>• Numër emërues</li> <li>• Numër një emërues</li> <li>• Numër shumëemërues</li> <li>• Shuma e numrave emërues</li> <li>• Ndryshimi i numrave emërues</li> </ul>	<p><u>Shembull:</u> Mate me vizore gjatësinë e fletës së fletores deri te milimetri më i afërt. Pastaj rumbullakojë deri te centimetri më i afërt..</p> <p>Shembull: Rafti është i gjatë 168 cm. Petriti e shkurtoi për 2 dm. Sa metra, sa decimetra dhe sa centimetra është i gjatë tani rafti?</p> <p><math>5\text{ m} + 20\text{ cm} = 520\text{ cm}</math> ili  <math>5\text{ m} + 20\text{ cm} = 5,2\text{ m}</math>  <math>12\text{ kg} \cdot 7 = 84\text{ kg}</math></p>

TEMA 5: PUNË ME TË DHËNA

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
<p>Nxënësi/nxënësjja aftësohet:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ti përgatisë instrumentet për grumbullimin e të dhënave;</li> <li>• të grumbullojë të dhëna sipas instrumentit të dhënë;</li> <li>• të paraqesë të dhëna në mënyra të ndryshme;</li> <li>• të zgjedh ekzemplar për hulumtim;</li> <li>• të bëjë pasqyrim për të dhënat e grumbulluara;</li> <li>• të bëjë analizën e të dhënave të grumbulluara;</li> <li>• të nxjerr përfundim.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Instrumente për grumbullimin e të dhënave</li> <li>• Paraqitja e të dhënave në tabelë</li> <li>• Paraqitja e të dhënave nga tabela në diagrame të llojeve të ndryshme</li> <li>• Zgjedhja e ekzemplarit për hulumtim</li> <li>• Analize të dhënave të marrua gjatë hulumtimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Pyetësor (fletë anketuese)</li> <li>• Hulumtim</li> <li>• Shembull</li> <li>• Propozim</li> <li>• Mesi aritmetik</li> </ul>	<p><u>Shembull:</u> Nxënësit e klasës Tuaj kultivojnë bimë në vende të ndryshme në klasë. Përgatit pyetësor me të cilin do të përfshihen lartësitë e të gjitha bimëve në centimetër, në pjesë të caktuar.</p> <p><u>Shembull:</u> Të dhënat e grumbulluara me pyetësorin nga shembulli paraprak paraqiti në diagram vijor. Shembull për hulumtim: Grumbullo të dhënat dhe caktoi syprinën dhe vëllimin e ndërtesës së shkollës tuaj – pa kulmin (e pjerrët). Shembull: Bëje një supozim se cili prej gjashtë numrave në një kub (1, 2, 3, 4, 5 ose 6) do të bie më shumë here, gjatë 36 hedhjeve të kubit. Më pas kubin hodhe 36 herë dhe shëno se sa here ka rënë secili nga numrat. Tregoi rezultatet në grafik numerik. Krahasoi me supozimin Tuaj.</p>

### 3. REKOMANDIME DIDAKTIKE

Gjatë realizimit të programit, realizuesit e drejtpërdrejtë të nisen nga mundësitë dhe interesat zhvilluese të fëmijëve të moshës 11 vjeçare. Në veçanti të merren parasysh ligjshmëritë e zhvillimit të mendimit në këtë periudhë zhvilluese..

Në realizimin e përmbajtjeve, realizuesit e drejtpërdrejtë duhet ta motivojnë nxënësin duke marrë shembuj nga mjedisi i drejtpërdrejtë ose duke realizuar përmbajtjet në kushte adekuate me problematikën që përpunohet. Duhet të organizohen aktivitete praktike siç janë: hulumtime, analiza të rasteve, vlerësime, konstruime, gjetja e zgjidhjeve me kombinim të ideve etj., kurse përmes tyre të nxiten aktivitetet ideale të nxënësve, me çka mundësohet ndërtimi i sistemit të shprehjeve dhe nocioneve matematikore. Nënkupton se në formësimin metodik-didaktik të orës mësimore shpeshherë të jenë të përfshira hulumtime të vogla, projekte, përkatësisht mësim përmes përvojave personale të nxënësit. Kështu ora e formësuar kërkon edhe forma adekuate të punës (grup-punë ekipore, punë në çifte si dhe punë individuale e nxënësit). Format tradicionale të punës ( para së gjithash puna e përbashkët (frontale) do të praktikohen gjatë prezantimeve, debateve, demonstrimeve të procedurave dhe ngjashëm, por gjithnjë më radhë si forma për bartjen e njohurive të nxënësve.

Për realizimin e mësimin nga matematika në klasën e VI do të përdoret libri në përputhje me Programin mësimor nga matematika për klasën e VI dhe me Konceptin për libër. Për matjen e të arriturave të nxënësve do të përdoren fleta pune, teste tematike dhe instrumente tjera, forma adekuate didaktike metodike në përputhje me programin mësimor, kurse për zgjerimin dhe thellimin e njohurive do të përdoren përmbledhje detyrash në përputhje me Programin mësimor nga matematika për klasën e VI. Përmbledhjet e detyrave duhet të përmbajnë pyetje dhe detyra të cilat do t'iu ndihmojnë nxënësve të talentuar për ta zhvilluar prirjen e tyre ndaj matematikës. Me punë së nxënës, e domosdoshme është korrelacioni me lëndët tjera mësimore të klasës së VI, që nënkup-

ton përputhshmëri në realizimin e këtyre përmbajtjeve nga matematika të cilat qëndrojnë në lidhje të ngushtë me përmbajtjet e ngjashme të programeve tjera lëndore dhe e kundërta. Integrimi i përmbajtjeve nga matematika me përmbajtje nga programet tjera lëndore do të realizohet në të gjitha situatat në të cilat është e pranishme lidhshmëri më e madhe e përmbajtjeve. Më pas do të jetë me rëndësi që edhe intensiteti të jetë më i madh i bashkëpunimit ndërmjet aktiveve të afërta profesionale në shkollë, kështu që edhe mundshme është edhe integrimi me përmbajtje të shkencave natyrore dhe teknikave.

Tema Punë me të dhëna realizohet në kuadër të temave paraprake.

Sipas natyrës të përmbajtjeve mësimore, mësimi nga matematika do të realizohet në vende të ndryshme, por më së shpeshti në klasë të specializuar ose në kabinet të matematikës ku nxënësi do të hulumtojë me materiale dhe mjete të ndryshme dhe do të punojë në kompjuter me zbatimin e softuerit arsimor të licencuar. Gjithashtu, nxënësi do të marrë pjesë në aktivitete të: radhitjes, klasifikimit, krahasimit, përqindjes, vlerësimit, qëllimit, numërimit, matjes, demonstrimit të veprimeve, prezantimeve të përpunimeve etj. Për këtë, mire do të ishte në klasën e specializuar për matematikë të ketë material dhe mjete tjera të parapara me Normativin për mjete mësimore dhe mjete ndihmëse.

## 4. VLERËSIMI I TË ARRITURAVE TË NXËNËSIT

Që të vlerësohen të arriturat e nxënësit e domosdoshme është:

- të shihet gjendja initiale e nxënësit (mbikëqyrja e përvojave, njohurive dhe shkathtësive të tija paraprake) gjatë hyrjes në klasë të VI;

Të bisedohet me nxënësin që të fitohen njohuri për të menduarit e tij logjike, kuptimin e nocioneve dhe shkallën e të kuptuarit gjatë zbatimit të tyre, aftësia për zgjidhjen e detyrave;

Ndjekje e vazhdueshme e raportit të nxënësit ndaj punës, bashkëpunimit me moshatarët, të treguarit e iniciativave, kureshtjes, pavarësisë, saktësisë në hulumtim dhe qëndrueshmërisë në realizimin e obligimeve; Përcaktim i vazhdueshëm dhe kontrollim i njohurisë së fituar, aftësive dhe shkathtësive të tërësive tematike;

Përdorimi i fletave të punës me tri nivele të peshës, teste të njohurive.

Në mbarim të gjysmëvjetorit të parë dhe në mbarim të vitit shkollor nxënësi vlerësohet me notë numerike.

Në mbarim të periudhës bëhet kontrollimi i të arriturave të qëllimeve të mësimin në klasën e VII. VIII dhe IX përmes testeve objektive të njohurisë.

## 5. KUSHTET HAPËSINORE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT MËSIMOR

Programi sa i përket kushteve hapësinore bazohet në Normativin për hapësirë për klasën e IV, V dhe VI dhe mjetet mësimore për klasën e VI të miratuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës me Vendim nr. 07-4061/1 më 31.05.2007.

## 6. NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR

Mësimdhënësi në mësimin lëndor, nga lënda e matematikës, mund të jetë personi i cili ka të kryer:

1. studime të kryera të grupit dylëndor matematikë-fizikë;
2. studime të kryera nga matematika, drejtimi mësimor.

Mësimdhënësit të cilët kanë mbaruar Akademinë Pedagogjike ose Shkollën e lartë pedagogjike - grupi përkatës dhe kanë fituar titullin mësimdhënësi i lëndës të cilën e ligjërojnë *nuk iu ndërpritet marrëdhënia e punës në vendin e punës* ku janë të angazhuar

## 7. REZULTATET E PRITURA NË MBARIM TË CIKLIT TË KLASËS SË IV - VI

Nxënësi/nxënësjja di:

- të paraqesë bashkësi, tabelore, përshkruese dhe me diagram të Venit;
- ti realizojë operacionet e unioneve, prerjen, ndryshimin dhe prodhimin e dekartit të bashkësive;

Në bashkësi numrat natyror mbi 1 000 000 di :

- ti lexojë, shkruajë dhe krahasojë numrat natyrorë;
- ti realizojë katër operacionet elementare aritmetike, ti përdorë vetitë e tyre dhe ta vlerësojë rezultatin;
- të caktojë vallë numri i dhënë natyror është i pjesëtueshëm me 2, 3, 4, 5 dhe i 9 dhe të paraqesë numër të përbërë me shumëzuesit e tij të thjeshtë;
- të llogarisë vlerën e shprehjes numerike në të cilën përmbahen operacionet aritmetike, ose disa prej tyre dhe ta vlerësojë rezultatin;
- të zgjidh barazime me ndihmën e operacioneve elementare aritmetike dhe ta kontrollojë saktësinë e zgjidhjes;
- të zgjidh detyrë tekstuale me të dhëna nga përditshmëria;
- të shndërrojë thyesat në numër dhjetorë dhe anasjelltas;
- ti kryejë katër operacionet elementare aritmetike të thyesave me emër-tues të barabartë dhe numra dhjetorë;
- të dallojë nocionet themelore dhe të nxjerra prej atyre gjeometrike;
- të sqarojë (përshkruajë) çka është gjysmëdrejtëza, segmenti, këndi, rrethi, harku, trekëndëshi, drejtkëndëshi dhe katrori;
- të njeh disa lloje të këndeve (fqinje, puçeta, tërthorazi (kryqëzuara), këndin qendror, këndet komplementare, këndet suplementare);
- të klasifikojë trekëndëshat sipas madhësisë së këndeve dhe sipas gjatësisë së brinjëve;
- grafikisht të mbledh dhe zbrit segmente;
- grafikisht dhe aritmetikisht të mbledh dhe zbrit kënde;

- të llogarisë perimetrin e llojeve të ndryshme të trekëndëshave, katrorit, drejtkëndëshit dhe shumëkëndëshit;
- të masë masën, gjatësinë, kohën, temperaturën dhe lëngjet dhe të bëjë vlerësimin e tyre;
- të shndërrojë numrat njëemëues në shumëemëues dhe të mbledh dhe zbrit numra emërues
- të llogarisë syprinën dhe vëllimin e kubit dhe kuadrit;
- të përmbledhë, përzgjedhë, radhisë të dhënat, ti vendos në tabelë, ti paraqesë në diagram dhe të lexojë të dhënat nga tabela dhe diagrami;
- të njohë, lexojë dhe shkruajë numrat romak deri 20;
- të përdorë teknologjinë informatike kompjuterike (TIK) në përmbajtjet nga matematika;
- të jetë i pavarur, i sigurt, i qëndrueshëm dhe këmbëngulës gjatë zgjidhjes së detyrave nga matematika.

Programin mësimor për *matematikë* për klasën e VI në arsimin fillor nëntëvjeçar e solli ministri i Arsimit dhe Shkencës me vendim nr. 07-668/2 më 05.11.2010.

ARSIMI FILLOR NËNTËVJEÇAR



HISTORI

PROGRAMI  
MËSIMOR

Në bazë të nenit 55 alineja 1 të Ligjit për organizim të punës së organeve të administratës shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 58/00, 44/02) dhe nenit 24 dhe 26 nga Ligji për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 44/95, 24/96, 34/97, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 63/04, 82/04, 55/05, 81/05, 113/05, 35/06, 70/06, 51/07) ministri për arsim dhe shkencë e solli Programin mësimorë për lëndën e *Historisë* për klasën e VI të shkollës fillore nëntëvjeçare.

## 1. HYRJE

Lënda e historisë ka rol të rëndësishëm në procesin edukativo-arsimor në arsimin fillor nëntëvjeçarë nga shkakun se nxënësit duhet të përvetësojnë dituri themelore të sistematizuara dhe të verifikuara shkencore. Ata duhet të fitojnë kuptimet themelore për të kaluarën dhe të tanishmen të historisë së civilizimit dhe etapave kryesore të saj. Të mësuarit e historisë duhet të ndërtojë vetëdije dhe qëndrime pozitive ndaj disa ngjarjeve, ndaj lëvizjeve dhe personaliteteve në luftën për demokraci dhe për të drejtat e njeriut.

Mësimi i historisë jep kontribut në ndërtimin e sistemit të vlefshëm të sjelljes ndaj popullit dhe shtetit të vet, ndaj popujve dhe shteteve tjera, t'iu ndihmojë të rinjëveta kuptojnë të tashmen në dritën e të së kaluarës dhe ta kuptojnë atë që përfaqëson arritje të civilizimit në botë në frymën e vlerave qytetare dhe demokracisë, si dhe ta thellojnë interesin për mësimin e mëtejshëm të ngjarjeve dhe proceseve historike.

*Fondi javor i orëve: 2 orë*

*Fondi vjetor i orëve : 72 orë*

*Statusi i lëndës: i obligueshëm*

## 2. QËLLIMET E LËNDËS PËR PERUIDHËN ZHVILLIMORE NGA KLASA E IV DERI NË KLASËN E VI

Nxënësi/ nxënësjat:

- Të fitojë dituri themelore për ngjarjet më të rëndësishme, dukuritë, proceset dhe personaliteteve të cilët kanë lënë gjurmë në historinë e njerëzimit;
- T'iu zbulojë lidhjet shkak- pasojë të dukurive historike dhe të zhvillojë mendimin kritik ndaj proceseve shoqërore-ekonomike gjatë tërë proceseve zhvillimore historike

- T'iu njohë proceset shoqërore dhe ndryshimet të cilat janë zhvilluar përmes ngjarjeve historike
- Të kuptojë lidhjet ndërmjet marrëdhënieve ekonomike, politike dhe sociale në shoqëri të caktuara përmes zhvillimit historik
- Të zhvillojë ndjenjën e patriotizmit ndaj popullit të vet dhe ndaj atëdheut, dhe njëkohësisht t'iu respektojë vlerat historike, shoqërore, ekonomike dhe dallimet e popujve në botë.
- Të kuptojë të kaluarën historike me qëllim që ta kuptojë të tanishmen, që të dijë ta ndërtojë të ardhmen e jetës së tij
- T'iu njohë dallimet kulturore dhe religjioze ndërmjet popujve
- Të zhvillojë ndjenjën e respektit dhe lojalitetit ndaj Republikës së Maqedonisë
- Të zhvillojë vetëdijen për identitetin e tij kombëtarë
- Të dijë në mënyrë të drejtë ti vështrojë ngjarjet dhe proceset në historinë e vet dhe në mënyrë krahasuese ta vështrojë historinë e popujve ballkanik dhe evropjanë
- Të zhvillohet ndjenja e mirëkuptimit ndëretnik në Republikën e Maqedonisë dhe e respektit ndërmjet shqiptarëve, maqedonëve turqëve dhe bashkësive tjera që jetojnë në R.M dhe popujve të Ballkanit, Evropës dhe botës përmes theksimit të kulturës së shteteve dhe popujve të ndryshëm
- Ta respektojë trashëgiminë historike dhe kulturore të Maqedonisë dhe popujve tjerë dhe të zhvillojë respekt për vlerat e gjithëmbarshme kulturore
- Të ndërtojë vetëdije për respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut

### 3. QËLLIMET E LËNDËS MËSIMORE NË KLASËN E VI

Nxënësi/nxënësjja:

- t'i dallojë perudhat historike dhe të dijë për karakteristikat themelore të tyre
- t'i njohë mënyrat e ndryshme të llogaritjes së kohës te popujt e vjetër
- t'i kuptojë regullimet shoqërore të shteteve nga Lindja e Lashtë me karakteristikat e veçanta të tyre
- t'i identifikojë karakteristikat e përbashkëta të shteteve të Lindjes së Lashtë
- të njihet me dukuritë dhe proceset e caktuara në parahistoria dhe në Kohën e Vjetër
- të njihet me rëndësinë dhe kontributin e personaliteteve për këtë periushë historike
- të njihet me zhvillimin e ekonomisë, shkencës dhe kulturës në shtetet e Lindjes së Lashtë
- të njihet me karakteristikat themelore të kulturës helene, ilire, romake dhe maqedone
- të njihet me përfitimet më të rëndësishme nga paraqitja, zhvillimi dhe forcimi i shtetit maqedon
- t'i vërejë dallimet dhe ngjajshmëritë tek popujt e ballkanit në periudhën e Kohës së Vjetër

## 4. QËLLIMET KONKRETE

Lënda mësimore : Histori			
Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të kuptojë pse mësohet Historia;</li> <li>• të njihet me lëndën, nocionin historik, dhe me detyrat e saja;</li> <li>• të njihet me ndarjen e historisë dhe me mënyrën e llogaritjes së kohës tek popujt e lashtë;</li> <li>• t'i përcaktojë dhe sqarojë periudhat historike (Koha e Vjetër, Koha e Mesme, Koha e re dhe Koha më e Re);</li> <li>• të njihet me burimet historike dhe rëndësinë e tyre për të kuptuar të kaluarën (burimet materiale, dokumente të shkruara dhe të dhëna gojore)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• HISTORIA DHE RËNDËSIA E SAJË</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Burime të shkruara</li> <li>• Historiografia</li> </ul> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Erë-epokë</li> <li>• Shekull</li> <li>• Parahistoria</li> <li>• Historia</li> <li>• Koha e Vjetër</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Punë me hartë historike dhe gjeografike- harta parahistorike, e kohës së vjetër dhe harta e Republikës së Maqedonisë;</li> <li>– tekst metoda: analiza e teksteve nga libri i historisë dhe nga tekstet tjera;</li> <li>- punë e pavarur e nxënësve: përpunimi i shiritit kohorë; shirit i periudhave historike;</li> <li>- ushtrime në shiritin e kohës</li> <li>- vështrim i dorëshkrimeve, librave të vjetra, atlaseve, hartave arkeologjike dhe burime tjera historike</li> </ul>

## PARAHISTORIA

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
<p>Nxënësi/nxënësj:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të njihet me teoritë e paraqitjes së njeriut sipas religjionit dhe shkencës;</li> <li>• të kuptojë rolin e punës në paraqitjen dhe zhvillimin e njeriut;</li> <li>• ta kuptojë rolin e zjarrit në ndryshimet në mënyrës e jetës së njeriut në parahistori;</li> <li>• ta kuptojë rëndësinë e zbulimit dhe përdorimit të metaleve;</li> <li>• t'i kuptojë nocionet dhe specifikat e mënyrës së jetës në horde, gjini, vllëzëri, fise;</li> <li>• të njihet me karakteristikat themelore dhe me shkaqet e shkatërrimit të bashkësive të para primitive dhe paraqitjes së shteteve të para.</li> <li>• Të njihet me shkaqet e paraqitjes së besimeve të para tek njerëzit;</li> </ul>	<p><b>EKZISTIMI I NJERIUT</b></p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• JETA E NJERIUT NË KOHËN E GURIT DHE METALEVE</li> <li>• BESIMI I NJERËZVE NË BASHKËSITË MË TË VJETRA</li> <li>• BESIMI I NJERËZVE NË BASHKËSITË MË TË VJETRA</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Evolucionit</li> <li>• Raca</li> <li>• Horda</li> <li>• Gjinia</li> <li>• Fisi</li> <li>• Vllëzëria</li> <li>• Religjioni</li> <li>• Koha e gurit</li> <li>• Koha e Metaleve</li> <li>• Vendbanime të pjerrëta</li> <li>• Burime (gurmë)</li> <li>• Arkeologji</li> <li>• Totem</li> <li>• Totemizëm</li> <li>• Animizëm</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Metoda demonstrative- Punë me hartën parahistorike të Maqedonosë, Blallkanit, Eporvës, Azisë, Afrikës;</li> <li>- Punë me material ilustrativ foto, maketa, (burimet historike); analiza e fotografive dhe vizatimeve.</li> <li>• Element – film, DVD, koha e gurit, koha e metaleve; film dokumentarë „Neandertali“</li> <li>• Rekonstruim i jetës (vendbanimet e para, veg lat e para në kohën e gurit dhe metaleve) veprimtaritë ekonomike ( ndarja e punës dhe veprimtarive) të njerëzve.</li> <li>• Hulumtim i mjedisit lokal objektet gjeografike dhe historike dhe karakteristikat e gjurmëve për historinë e vendlindjes (Mësim në natyrë: vizitë e lokaliteteve, muzeve, ekspozitave ejt. veçmas të muzeve dhe lokaliteteve arkeologjike)</li> </ul>

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
<ul style="list-style-type: none"> <li>• t'i njohë format e para të besimit të njerëzve në forca të ndryshme mbintyrore dhe besimeve të ndryshme të lidhura me jetën e tyre dhe me shpjegimin për prejardhjen e tyre.</li> <li>• t'i dijë lokalitetet më të rëndësishme arkeologjike në vendet ballkanike dhe në Maqedoni;</li> <li>• të njihet me artefaktet, burimet historike arkeologjike pqr periudhën e parahistorisë në vendet e Ballkanit dhe në Maqedoni</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• BALLKANI DHE MAQEDONIA NË PARAHISTORI</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kokinë</li> <li>• Kalaja e Vinicës</li> <li>• Govërlevë</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Oranzizimi i mësimit interaktiv me mësimdhënësin e artit figurativ dhe përpilimi i ilustrimeve dhe vizatimeve për jetën e njeriut në parahistori.</li> <li>• Përpunim i maketave për vendbanime, vegla dhe mjete nga jeta e njerëzve në parahistori.</li> <li>-Njohja me burimet historike të parahistorisë në Maqedoni përmes fotografive, vizitë në muze dhe në lokalitete të ndryshme.</li> </ul>

## CIVILIZIMET NË LINDJEN E LASHTË

<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të Përvetësojë, ushtrojë dhe perfeksionojë qëndrime hendbolistike bazë dhe lëvizje, teknikat bazë të kapjes dhe pasimit të topit në vend dhe lëvizje,</li> <li>• të zhvillojë motorikë manipulative;</li> <li>• të zhvillojë lëvizje motorike të ekstremiteve dhe koordinim specifik hendbollistik në hapësirë;</li> <li>• zhvillon forcë eksplozive të muskujve të duarve dhe të këmbëve;</li> <li>• të inkuadrohet dhe t'i aplikojë rregullat e lojës hendbolistike;</li> <li>• ta zhvillojë frymën e garimit korrekto-sportive dhe fair-play.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Qëndrime dhe lëvizje: <ul style="list-style-type: none"> <li>- qëndrimet hendbolistike bazë: paralel, diagonal, anësor;</li> <li>- Pasimi dhe kapja e topit në vend dhe lëvizje( në lartësi të ndryshme të trupit)me një dhe dy duar;</li> </ul> </li> <li>• Udhëheqje: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Udhëheqja e topit në vend dhe lëvizje me dorën e majtë dhe të djathtë(drejtvizor dhe mendrim të drejtimit dhe shpejtësisë së lëvizjes;</li> </ul> </li> <li>• Gjuajtjet: <ul style="list-style-type: none"> <li>- Gjuajtje në portë nga vendi dhe lëvizja( me dhe pa kërcim);</li> </ul> </li> <li>• Lojë: <ul style="list-style-type: none"> <li>- lojë në një dhe dy porta me aplikimin e rregullave;</li> <li>- aplikimi i elementeve të hendbollit në lojëra stafetore.</li> </ul> </li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nocione nga hendbolli</li> </ul>	<p>Ushtrime, qëndrime dhe lëvizje në hendboll, pa dhe me top;</p> <p>Pasimi dhe kapja e topit në vend( me ndryshim të distancës) me një dorë në lartësinë e krahërorit dhe e dëbuar nga toka, pasimi dhe kapja mbi kokë, pasimi dhe kapja në dyshe në lëvizje me përfitimin e hapësirës, pasimi dhe kapja e topit e kombinuar me udhëheqje dhe gjuajtje në portë;</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Udhëheqja e topit në vend dhe lëvizje(drejtvizorisht), udhëheqje me ndim të drejtimit dhe intensitetit, udhëheqja e topit me dorën e djathtë dhe të majtë nëpër pengesa „zik-zak,, udhëheqje e kombinuar me pasim, kapje dhe goditje në portë;</li> <li>• Demonstron goditje në portë nga vendi (6,7 dhe 9m.), goditje në portë në lëvizje me udhëheqjen e topit( me dhe pa kërcim), gjuajtje në portë të kombinuara me pasim, kapje dhe udhëheqje të topit;</li> <li>• Lojë në një dhe dy porta me aplikimin e rregullave;</li> </ul>

## BASKETBOLL

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
<p>Nxënësi/ nxënësjat:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• Të përvetësojë, ushtrorë dhe përfeksionojë qëndrime dhe lëvizje basketbollistike bazë, teknika bazë të pasimit, kapjes dhe udhëheqjes së topit në vend dhe lëvizje;</li> <li>• të zhvillojë motorikë manipulative dhe koordinim në hapësirë;</li> <li>• të zhvillojë lëvizje të përgjithshme dhe të veçanta të aparatit lokomotor;</li> <li>• ta zhvillojë frymën e garimit korrekt -sportiv dhe „fair-play,“;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Qëndrime dhe lëvizje               <ul style="list-style-type: none"> <li>- Qëndrime dhe lëvizje basketbollistike(paralel dhe diagonal);</li> </ul> </li> <li>• Kapje dhe pasim:               <ul style="list-style-type: none"> <li>- pasim basketbollistikë dhe kapje në vend dhe lëvizje(në lartësi të gjoksit, kokës dhe mbi kokë);</li> </ul> </li> <li>• Udhëheqje:               <ul style="list-style-type: none"> <li>- udhëheqje basketbollistike e topit në vend dhe lëvizje;</li> </ul> </li> <li>• Gjuajtje:               <ul style="list-style-type: none"> <li>-Gjuajtje në shportë nga vendi ;</li> </ul> </li> <li>• Lojë:               <ul style="list-style-type: none"> <li>- lojë në një kosh me aplikimin e elementeve të mësuara dhe rregulla të modifikuara;</li> </ul> </li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Basketboll;</li> <li>• Qëndrime në basketboll;</li> <li>• Udhëheqje të kombinuara;</li> <li>• Top i dyfishtë gjatë udhëheqjes së hapave .</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ushtrimi i qëndrimeve dhe lëvizjeve pa dhe me top; pasimi dhe kapja e topit në vend( me ndrimin e distancës) me dy duar në lartësi të gjoksit, dhe e dëbuar nga toka, pasim dhe kapje mbi kokë, pasim me një dorë; pasimi dhe kapja e topit në dyshe në lëvizje me përfitim të hapësirës, kapje dhe pasim e kombinuar me udhëheqje; udhëheqja e topit në vend dhe lëvizje drejtvizotisht, me ndrim të drejtimit dhe intenzitetit, udhëheqja e topit me dorën e majtë dhe të djathtë „zik-zak,, nëpër pengesa, udhëheqje e kombinuar me udhëheqje, paasim dhe kapje të topit, gjuajtje në kosh nga vendi me ndrim të distancës dhe pozicioneve( gjuajtje të lira prej distancës më të shkurtë, nga ana e djathtë dhe e majtë pa shfrytëzimin e tabelë etj.) ;</li> <li>• organizon lojë( me rregulla të modifikuara) në një kosh;</li> <li>• Lojëra stafetore me elemente të mësuara të basketbollit;</li> </ul>

## TËRËSI TEMATIKE-LËMI TË CILËT REALIZOHEN NËPËRMJET MARËVEVESHJES ME PRINDËRIT:

- NOT ME AKTIVITETE NË UJË DHE TRAINIM
- SKI ME TRAINIM
- SHËTITJE ME ECJE
- SPORTI SHKOLLOR
- SHKOLLA SPORTIVE

### 3. UDHËZIME DIDAKTIKE

Mësimi i arsimit fizik dhe shëndetësorë në klasën e gjashtë realizohet me tri orë në javë gjegjësisht 108 orë në vit.

Programi mësimor për arsim fizik dhe shëndetësorë për nxënësit organizohet dhe realizohet nëpërmjet elementeve të mësuara nga programet mësimore. Programi mundëson kontinuitet të programeve mësimore parraprake me inkuadrimin e specifikave të moshës dhe përbajtjet që vinë si pjesë shtuese në temat duke i sintetizuar elementet e mësuara nga sportet dhe elementet e reja të cilët duhet gjatë mësimin të përvetësohen në pajtim me mundësitë e nxënësve me qëllim të arrihet kualitet më i lartë në mësim dhe një spektër më i gjërë të elementeve të mësuara nga sportet dhe arritje të efekteve shëndetësore.

Tema e parë Ushtrime dhe lojëra për zhvillim të drejt dhe përgatitje ngel si nevojë e përgjithshme dhe bazike për nxënësit për ngritje permanente të aftësive fizike të përgjithshme dhe lëvizshmëri i aparatit lokomotor dhe organizmit në tërësi, për të cilën mësimdhënësit duhet t'i kushtojnë vëmendje në zgjidhjen dhe ndikimin e ushtrimeve, elementet dhe lojërat me dozim të matur dhe ndryshueshmëri në punën të mbahet dhe të përparojë interesi dhe motivacioni për të ushtruarit. Mësimdhënësit duhet të kushtojnë rëndësi të veçantë nxënësit në mënyrë të drejtë t'i ekzeku-

tojnë elementet me rekuizita dhe ndihmesa konform mundësive dhe moshës.

Temat e tjera mësimore mësimdhënësi duhet t'i kahëzojë në drejtim të përvetësimit të elementeve të reja, të ekzekutohen në mënyrë të drejtë dhe njëkohësisht ta ngitë njohurinë sportive në nivel më të lartë.

Mësimdhënësi e pëccjell statusim morfologjik të nxënësve dhe ndëmerr masa gjatë paraqitjes eventuale të deformiteteve trupore edhe atë me intensitet më të fuqishëm dhe kujdes ndaj ketij problemi me aplikim të kompleks të ushtrimeve adekuate. Për atë gjatë çdo orë të arsimit fizik dhe shëndetësorë detyrimidhe ekzekutohen ushtrime për formimin e trupit dhe të lëvizjeve, ndërsa mësimdhënësi duhet nxënësve t'ju jep edhe detyra shtëpie për ushtrimin e ushtrimeve for formimin e trupit simetrik dhe lëvizje.

. Në bashkëpunim me prindërit, mësimdhënësi përgatit programe për përbajtjet e zgjedhura – tema – lëmi mësimore.

## 4. NOTIMI I TË ARRITURAVE TË NXËNËSVE

Sipas ligjit për arsim fillor, Koncepti dhe qëllimet e programit mësimor për arsim fizik dhe shëndetësorë, të arriturat e nxënësve nga klasa e katërt gjer të gjatshën vlerësohen në mënyrë të kombinuar – në mënyrë të përshkruar me nxjerrjen e notës numerike gjatë mësimit, ndërsa në fund të vitit shkollor me notë numerike.

Gjatë formimit të notës numerike mësimdhënësi kujdeset për gjithë të arriturat e nxënësit në mësim, sepse të gjithë ato janë në mënyrë të barabartë të rëndësishëm. Gjegjësisht, ai notën numerike e formon sipas angazhimit të nxënësit, njohuritë sportive, përparim fizik dhe i aftësive, angazhimi, rregullsia, komunikimi, sjelljes „fair-play“, bashkëpunim dhe ndihmë, përmbushja e kushteve dhe shprehive higjieniko-shëndetësore para dhe pas realiyimit të mësimit. Në arsimin fizik dhe shëndetësorë nuk ka orë të veçanta për notim. Mësimdhënësi gjithë çto ore i përcjel të arriturat e nxënësit në të gjithë komponentat, i evidenton dhe në bazë të atyre formon notë. Gjatë orës së arsimit fizik dhe shëndetësorë mësimdhënësi në veçanti kujdeset mësimit ta realizojë pa asnjë stres ose situata stresi, ashtu që nxënësi secilën orë duhet ta përfundojë me ndjenje pozitive emocionale.

Aftësitë fizike tek nxënësit janë të ndryshme, dhe për atë shkak mësimit prej atyre nuk duhet të kërkojë norma të ndryshme për notë. Secili individualisht notohet në batë të angazhimit dhe aftësive, rregullsisë dhe elementeve të tjera. Indikatorët e shëndetit(aftësitë psikomotorë dhe funksionale) janë norma për notim, ato janë elemente për mësimdhënësin që të dijë se cilin nxënësi sa duhet ta ngarkojë në suaza të ndikimit pozitiv.

## 5. REZULTATE TË PRITURA

Nxënësi/nxënësja:

- ekzekuton në mënyrë të drejtë lëvizje natyrore me duar, këmbë dhe trugun dhe aparatit lokomotor në tërësi në hapësirë;
- ekzekuton kompleks ushtrimesh për zhvillim simetrik morfologjik dhe për mbajtjen e drejt të trupit;
- drejt ta mbajë trupin dhe të ekzekutojë ushtrime në drejtdëndrim, pupçik, në gju dhe i shtrirë në shpinë dhe stomak;
- në mënyrë të drejt, simetrikisht të lëvizë në kolonë(nga 2 dhe nga katër);
- në mënyrë të rregullt dhe eksplozivisht të kërcejë nga vendi dhe kryjë rënien;
- ekzekuton elemente gjimnastikore të koordinuara dhe të drejta në dysheme dhe mbi trarë;
- ekzekuton elemente gjimnastikore në dysheme;
- ekzekuton elemente të drejta ritmike: ecje, vrapim dhe kërcime ritmike pupthi dhe kthime;
- ekzekuton lëvizje të harmonizuara ritmike, ekzekuton vallëzime dhe lojëra të në ritme dhe lëvizje të ndryshme dhe merr pjesë në ekzekutimin e valles popullore dhe vallëzimit modern;
- ekzekuton udhëheqje të rregullt dhe lojë me top në ndonjë lojë sportive si dhe elemente të tjera të lojërave sportive bazë,( kap, pason dhe ekzekuton hedhje të koordinuara dhe precize – gjuajtje cak të përcaktuar(portë, kosh etj.);
- i di nocionet e elementeve dhe rekuizitave sportive, ndihmesave nga atletika, gjimnastiks me ritmikë, bazën e vallëzimeve dhe lojërave sportive, notit dhe skive nga programi mësimor;
- bashkëpunon, ndihmon dhe ka aftësi të punojë në mënyrë ekipore dhe të merr pjesë në lojë, sillet fair-play gjatë aktiviteteve në shkollë dhe jashta saj.

## 6. KUSHTET HAPËSIRORE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT MËSIMOR

Programi në bazë të kushteve bazohet në Normativin për hapësirë, përgatitje dhe mjete materiale për shkollë fillore nëntëvjeçare e miratuar nga ministri për arsim dhe shkencë me vendimin nr. 07-1830/1 prej 28.02.2008.

## 7. NORMATIV PËR KUADRIN ARSIMOR

Për realizimin e programit mësimorë të arsimit fizik dhe shëndetësorë për klasën e gjashtë në arsimin fillor janë parapa mësimdhënës me fakultet të kulturës fizike të kryer- drejtimi arsimor.

Programin mësimor nga *arsimi fizik dhe shëndetësor* për klasën e VI në arsimin fillor nëntëvjeçar e solli ministri i Arsimit dhe Shkencës me vendim nr. 07-4084/1 me 22.05.2008.

ARSIMI FILLOR NËNTËVJEÇAR



**PROGRAMI  
MËSIMOR**

**ARSIMI TEKNIK**

Në bazë të nenit 55 paragrafit 1 të Ligjit për organizimin e punës së organeve të drejtorisë shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 58/00, 44/02 dhe 82/08) dhe neni 24 dhe 26 paragrafi 2 të Ligjit për arsimin fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 44/95, 24/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 63/04, 82/04, 55/05, 81/05, 113/05, 35/06, 70/06 dhe 51/07), ministri i Arsimit dhe Shkencës e miratoi programin mësimor për lëndën *arsimi teknik* për klasën e VI në arsimin fillor nëntëvjeçar.

## 1. QËLLIMI I MËSIMIT NË KLASËN E VI

Nxënësi/nxënësjja:

- të zhvillojë njohuri të reja nga teknika dhe teknologjia përmes burimeve të ndryshme të mësimit dhe detyrave;
- të aftësohet për zbatimin e njohurive themelore teknike – teknologjike, njohuritë dhe shprehitë në punë dhe jetën e përditshme;
- t'i zgjerojë njohuritë për realizimin e idesë deri te realizimipërfundimtar;
- të zhvillojë shkathtësi për krijimin teknik (puna me materiale, konstruksion dhe dizajn);
- t'i zgjerojë dhe zbulojë njohuritë për cilësitë e materialeve;
- të aftësohet për hulumtimin, zbulimin dhe krahasimin e dukurive, shembujve dhe elementeve në teknikë dhe teknologji;
- ta zhvillojë kreativitetin dhe afinitetin për dizajn përmes aplikacioneve kompjuterike- ta zhvillojë kreativitetin dhe afinitetin për dizajn përmes aplikacioneve kompjuterike;
- t'i zgjerojë njohuritë dhe shkathtësitë për lëvizjen e sigurt në trafik;
- të zhvillojë kulturën e sjelljes në trafik;

## 2. QËLLIMET KONKRETE

TEMA 1: VIZATIM TEKNIK DHE DIZAJN			
Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
<p>Nxënësi/nxënësjja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të njeh dhe lexon vizatime teknike;</li> <li>• krijon vizatim me figurat themelore gjeometrike;</li> <li>• të krijojë model të figurës themelore gjeometrike, kuti;</li> <li>• të njihet me bazat e dizajnit dhe kuptimet e tij;</li> <li>• të din të realizojë dizajn me qëllim/temë të caktuar;</li> <li>• të njeh veglat themelore të aplikacionit kompjuterik për vizatim;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Llojet e vizatimeve teknike</li> <li>• Vizatimi i figurave dhe pikturave të thjeshta (skica dhe vizatimi teknik)</li> <li>• Elementet dhe fazat e dizajnit</li> <li>• Dizajni grafik</li> <li>• Përpunimi i dizajnit grafik (ideja, skica, zgjidhja, përpunimi)</li> <li>• Vizatimi teknik dhe dizajni me zbatimin e TIK aplikacioneve (zgjidhja grafike, enterier, eksterier)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Modeli</li> <li>• Dizajni</li> <li>• Prodhimi</li> <li>• Ideja</li> <li>• Aplikacioni</li> <li>• Ambalazhi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Krijimi i vizatimeve teknike të figurave themelore gjeometrike – skicim idesh.</li> <li>• Vizatimi i rrjetit në trupin gjeometrik (kutia për ambalazhim).</li> <li>• Njohja me bazat e dizajnit, rëndësia e tij në botën bashkëkohore përmes shembujve.</li> <li>• Shfrytëzimi i veglave themelore kompjuterike në aplikacionet për vizatim dhe dizajn (Google Sketch – up dhe aplikacione tjera për të vizatuar).</li> <li>• Dizajnimi i prodhimit final;</li> <li>• Shtëpia ime, klasa ime – detyrë projektuese me zbatimin e PRO/DESKTOP ose aplikacione tjera.</li> <li>• Evolucionimi dhe vlerësimi.</li> </ul>

## TEMA 2: PUNA ME MATERIALE DHE KONSTRUIME

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
<p>Nxënësi/nxënësjja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>t'i njeh materialet themelore teknike (kartuç, dru, tekstil, tel të thjeshtë);</li> <li>të din të shfrytëzojë veprime gjatë ndërtimit të modeleve dhe maketeve;</li> <li>të arrijë shkathtësi për punën me materiale të thjeshta (kartuç, dru, tekstil, tel të thjeshtë);</li> <li>të din të formësojë dhe dizajnojë në mënyrë estetike;</li> <li>t'i llogarisë në mënyrë racionale kohën dhe materialet gjatë ndërtimit;</li> <li>të kryejë evoluimin dhe ta vlerësojë punën individuale dhe të huaj;</li> <li>ta njeh arkitekturën maqedonase, karakteristikat, rëndësinë;</li> <li>të konstruktojë dhe përpunojë modele dhe prototipe;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Zbatimi i materialeve teknike</li> <li>Planifikimi, procedurat dhe dizajnimi me materiale gjatë ndërtimit (makete, modele, prodhime)</li> <li>Ndërtimi dhe konstruksione me materiale të thjeshta (dru, kartuç, letër, tekstil, tel i butë)</li> <li>Elemente për përcjelljen e lëvizjes dhe zbatimi i tyre në modele dhe konstruksione (rripi, rripi i vogël, boshti, dhëmbëzimi etj)</li> <li>Zbatimi i pajisjeve elektrike, elektronike me rezistencë të vogël në modele. (bateria, elektromotori, poçja elektrike)</li> <li>Zbatimi i pajisjeve për lëvizje dhe rregullim të ndërli dhura me kompjuter</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Makete</li> <li>Konstruksionet</li> <li>Rripi</li> <li>Rripi i vogël</li> <li>Boshti</li> <li>Rezistenca</li> <li>Elektromotori</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Video ose PP prezantime për materialet teknike dhe zbatimi i tyre.</li> <li>Realizimi i ideve dhe mendimeve përmes vizatimeve teknike (shembull për dizajnin e prodhimit).</li> <li>Hyrja në detyrën projektuese (Power Point prezantimi, hapat, qëllimet dhe realizimi).</li> <li>Shfrytëzimi i aplikacioneve të softuerit: (<a href="http://www.data.org.uk/CAD/CAM">www.data.org.uk/CAD/CAM</a>) GoogleSketchUp.</li> <li>Realizimi i detyrave praktike përmes hapave/fazave: skicimi i idesë, zgjedhja e materialeve, realizimi i prodhimeve, vlerësimi i vlerësimit/evolucioni.</li> <li>Hulumtimi i detyrave dhe demonstrimi me elemente dhe mekanizma bartëse.</li> <li>Zbulimi i funksionit të rregullimeve dhe modeleve të cilët lëvizin: shpejtësia, drejtimi, koha e lëvizjes etj.</li> <li>Vizatimi i idesë për rotulluesen ose objekt tjetër me PRO/DESKTOP ose fjalë në material</li> <li>Realizimi i prodhimit, evoluimi.</li> <li>Detyrë projektuese – konstruksioni i shtëpisë solari, ose shtëpi nga arkitektura e vjetër.</li> </ul>

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
<ul style="list-style-type: none"> <li>• t'i identifikojë fazat në punë;</li> <li>• të kuptojë se çka është dizajni;</li> <li>• të din të dizajnojë enterier sipas mendimit të vet;</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nga ideja në realizim</li> <li>• Arkitektura maqedonase</li> <li>• Materialet ndërtimore dhe zbatimi i tyre në ndërtimet bashkëkohore</li> <li>• Kursimi i energjisë në ndërtimtari</li> <li>• Nga ideja në objekt të gatshëm</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Arkitektura</li> <li>• Materialet ndërtimore</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njohja përmes shembujve me standarde dizajni për enterierë etj. (PP prezantimi).</li> <li>• Zbatimi i materialeve konstruktive Built it kit.</li> <li>• Hyrja në aplikacionet për dizajn: (PRO/DESKTOP (<a href="http://content.yudu.com/">htt://content.yudu.com/</a>) ose Envisioneer Express 3.0 (free) ose RoomArranger (free).</li> <li>• Përcjellja, evoluimi dhe vlerësimi.</li> </ul>

### TEMA 3: TRAFIKU

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• t'i zgjerojë njohuritë për rregullat dhe dispozitat në trafik;</li> <li>• të krijojë shprehi për pjesëmarrje në trafik;</li> <li>• të bëjë analiza në situata të trafikut sipas rregullave dhe dispozitave të trafikut;</li> <li>• të din të zgjidh situatë problematike në trafik.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbatimi i rregullave të trafikut dhe dispozitat në trafikun rrugor</li> <li>• Detyra projektuese me zbatimin e aplikacioneve të softuerit</li> <li>• Përpunimi dhe zgjidhja e situatave problematike në trafik</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Situata të trafikut</li> <li>• Dispozita</li> <li>• Aplikacione</li> <li>• Projekte</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Analiza e situatave të trafikut dhe dispozitat për sjellje të sigurt në trafik.</li> <li>• Përpunimi dhe zgjedhja e situatave të trafikut.</li> <li>• Demonstrimi i veprimeve për zgjidhjen e situatave me shfrytëzimin e aplikacioneve kompjuterike.</li> <li>• Shfrytëzimi i aplikacioneve programore (Alice).</li> <li>• Përcjellja, evoluimi dhe vlerësimi.</li> </ul>

### 3. REKOMANDIMET DIDAKTIKE

#### *Udhëzime për lidhshmërinë ndërlendore*

Përmbajtjet mësimore nga lënda mësimore e arsimit teknik japin mundësi për integrim të plotë dhe lidhshmëri përmbajtjesore me lëndët mësimore: matematikë, arsim figurativ, njohja e mjedisit dhe natyrë.

Qëllimet e parashtruara në temat mësimore japin mundësi për planifikim dhe realizim të pavarur të përmbajtjeve, në pajtim me përparimin dhe nevojat e nxënësve, si dhe respektimin e parimit të aktualizimit në mësimin për arsim teknik. Shfrytëzohen risitë, situatat, proceset e punës aktuale punuese dhe teknologjike, dhe ndërlihen me përvojën e arritur të nxënësve, veçanërisht nga lënda mësimore njohja e mjedisit në shkollë dhe jashtë saj. Gjatë vrojtimit, instruksioni dhe demonstrimit nxënësit udhëzohen të përdorin veprimet dhe instrumentet në njohjen dhe zbatimin e njohurive të fituara në jetën e përditshëm dhe në praktikë. Në programin mësimor gjithashtu, janë dhënë edhe objektivat konkrete të cilat arrihen përmes aktiviteteve të nxënësve të cilat planifikohen për përvetësimin e përmbajtjeve të parapara dhe për zhvillimin e aftësive të nxënësve për kreativitet, inovativitet dhe shkathhtësi gjatë punës me materiale. Gjatë klasës së VI nxënësit do të kenë mundësi të njihen dhe aftësohen për realizimin e ideve personale dhe realizimin e shpikjes në prodhim të gatshëm, konstruksioni (makete apo model). Qasja e tillë e programeve të përpiluara mësimore parashikojmë se tek nxënësit do të jetë me rëndësi të ndikojë zhvillimi i krijimtarisë teknike, inovativiteti, kreativiteti dhe aftësia për organizim.

Aktivitetet e parapara në programin për klasën e gjashtë përfshijnë më tepër qëllime dhe ofrojnë mundësi për realizimin përmes formave të ndryshme bashkëkohore, të ndryshme, metodat, modelet dhe qasjet. Kështu që realizimi i qëllimeve gjatë realizimit të përmbajtjeve mësimore, mësimdhënësit mund ta arrijnë përmes më tepër aktiviteteve të ndryshme, ndërsa parapakisht duke përdorur materiale adekuate dhe të reja didaktike dhe teknologji.

Lënda mësimore në klasën e VI mësohet me nga 1 orë në javë, gjegjësisht 36 orë në vit

#### *Mjetet mësimore*

- në mësimin për arsim teknik, për mirëkuptimin e dukurive dhe ligjshmërive, si dhe dukuritë në shoqëri dhe raportet ndërmjet njerëzve e domosdoshme është të shfrytëzohen mjetet mësimore nga procedurat dhe situatat reale dhe stimuluese;
- për arritjen e qëllimeve të theksuara në programin mësimor nga arsimi teknik duhet të përgatitet libër dhe të përgatiten materiale për mësimin nga ana e shkollës;
- kënd hulumtues ku nxënësit mund të hulumtojnë sipas qëllimeve dhe mësimin;
- mjetet didaktike dhe të tjera vizuale: filma, kompjuter, aplikacione, foli, pana, sllajde, modele, makete et.;
- enciklopedia dhe revista nga lëmi i shkencës dhe teknikës;
- internet, softuer arsimor;
- mjetet audio dhe vizuale. Kamerë digjitale, grafoskop, DVD, LCD projektor.

## 4. VLERËSIMI I TË ARRITURAVE TË NXËNËSVE

### *Përcjellja e të arriturave të nxënësve*

Gjatë mësimit rregullisht përcjellën dhe vlerësohen të arriturat e nxënësve, grumbullohen treguesit për aktivitetet e tyre, ndjekje motivimi për mësim, bashkëpunimin me nxënësit dhe ngjashëm (vlerësimi formativ). Kjo komponentë është pjesë përbërëse e punës të mësimit dhe mësimit i nxënësit.

### *Mënyra e kontrollimit dhe vlerësimit:*

- punime/përpunime të nxënësve, grupe dhe në mënyrë individuale;
- teste kontrolluese, teste të njohurive;
- aktivitete punuese eksperimentale hulumtuese (planifikimi i punës, aftësitë për hulumtim, aftësitë për arritjen e shprehive të punës).

## 5. KUSHTET HAPËSINORE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT MËSIMOR

Programi sa i përket kushteve hapësinore për realizim bazohet në Normativin për hapësirë, pajisje dhe në mjetet mësimore për klasën e VI të miratuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës me Vendim nr. 07-1830/1 më 28.02.2008.

## 6. NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR

Punën edukative-arsimorë në klasën e VI mund ta realizojë personi i cili ka të kryer:

- Fakultetin Pedagogjik – profesor për mësim klasor;
- Fakulteti Filologjik – pedagog i diplomuar.

## 7. REZULTATET E PRITURA

Nxënës/nxënësja:

- Me rregull ta organizojë vendin e punës;
- Të përdorë vegla për vizatim teknik;
- Të përdorë skicë dhe vizatime teknike për ndërtim dhe formësim të modeleve dhe maketeve;
- Skicon modele ose makete sipas idesë së vet;
- Është i aftë të bëjë vizatime të thjeshta teknike;
- Hulumton zgjidhje bashkëhore për dizajnim të vizatimeve teknike me TIK;
- Përpunon, krijon prodhime, makete ose modele;
- Zbaton rregulla dhe shprehje kulturore në punë;
- Identifikon faza dhe procedura gjatë ndërtimit të detyrave dhe konstruksioneve të caktuara;
- Di për burimet e energjisë, forcës, bartjes së fuqisë dhe lëvizjes;
- Vlerëson sipas kriterëve të dhëna, saktësi, kohë, funksionim, dizajn;
- Mendon ide për projekte hulumtuese me TIK;
- Formon qëndrim për pjesëmarrjetë sigurt dhe të drejtë në komunikacion;
- Përpunon dhe zgjidh situata komunikacioni;
- Shfrytëzon TIK aplikacione.

Programin mësimor nga *arsimi teknik* për klasën e VI në arsimin fillor nëntëvjeçar e solli ministri i Arsimit dhe Shkencës me vendim nr. 07-4497/1 me 17.12.2010.

ARSIMI FILLOR NËNTËVJEÇAR



INFORMATIKË

PROGRAMI  
MËSIMOR

Në bazë të nenit 55 paragrafi 1 të Ligjit për organizim dhe punë të organeve të drejtorisë shtetërore („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 58/00, 44/02) dhe neni 24 dhe 26 të Ligjit për arsim fillor („Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 44/95, 24/96, 34/96, 35/97, 82/99, 29/02, 40/03, 42/03, 63/04, 82/04, 55/05, 81/05, 113/05, 35/06, 70/06, 51/07) ministri i Arsimit dhe Shkencës miratoi Programin mësimor nga lënda e *informatikës* për klasën e VI në arsimin fillor nëntëvjeçar.

## 1. HYRJE

Mësimi i lëndës së *Informatikës* . Nxënësit me këtë lëndë mësimore do të fitojnë njohuri elementare për të udhëhequr me kompjuterin dhe shfrytëzimin e programeve të ndryshme kompjuterike, si dhe shfrytëzimin e TIK në lëndët tjera mësimore.

Aftësimi i nxënësve për shfrytëzimin e TIK do t'iu mundësojë lehtësimin e procesit për vetëmësim, si dhe përfshirjen e tyre në qasjet e ndryshme për jetë.

Lënda e Informatikës është lëndë e detyrueshme në klasë të VI me 2 orë në javë (72 orë në vit) dhe në klasë të VII me 1 orë në javë (36 orë në vit).

## 2. QËLLIMET E MËSIMIT NË KLASË TË VI

Nxënësi/nxënësja të aftësohet:

- ta përshkruajë ndërtimin, funksionin dhe zbatimin elementar të kompjuterit;
- drejtë ti përdorë pajisjet nga klasa e kompjuterëve;
- të ketë sjellje etike në klasën e kompjuterëve;
- ta përdorë sistemin operues me kompjuterin dhe të kryejë aktivitete të zakonshme me dritare dhe ikona, follderë dhe datoteka;
- shfrytëzojë shërbimet e Internetit për mësim, kërkim të fjalëve dhe kategorive kyçe, pranimin dhe kthimin e porosive elektronike;
- ti shfrytëzojë programet multimediale për pasqyrim dhe krijim të dokumenteve të rëndomta multimediale;
- të shfrytëzojë programin për vizatim, për krijim dhe rregullim të vizatimeve të zakonshme;
- të shfrytëzojë tekst-rregullues për futje dhe rregullim të rëndomtë të tekstit;
- të aftësohet të përdorë programe për mësim të lëndëve tjera mësimore (softuer arsimor);
- të fitojë njohuri elementare informatike si bazë për ndërtimin e procesit të shkollimit të mëtutjeshëm.

### 3. QËLLIMET KONKRETE

BAZAT E IONFORMATIKËS			
Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
<p>Nxënësi/nxënësj:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ti njohë nocionet elementare të informatikës;</li> <li>• të dallojë llojet e ndryshme të kompjuterëve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nocionet kryesore</li> <li>• Histori e shkurtë e kompjuterëve</li> <li>• Llojet e kompjuterëve (klasifikime të ndryshme);</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Informatika</li> <li>• Të dhënat</li> <li>• Informata</li> <li>• Kompjuterët</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njohja me historinë e kompjuterëve sipas krahasimit të pamjes, mundësive, shpejtësisë të gjeneratave të ndryshme të kompjuterëve duke përdorur material ilustrues dhe fotografi dhe informata nga Interneti.net.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• ti identifikojë lëmit në të cilat përdoren kompjuterët në shoqëri.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Zbatimi i kompjuterëve në shoqëri (e-shoqëri)</li> </ul>		<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hulumtime lidhur me lëmit në të cilat zbatohen kompjuterët dhe çfarë funksioni kanë</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• ti njohë dhe ti zbatojë normat dhe të drejtat elementare për sjellje etike në kabinetin e kompjuterëve.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kultura dhe etika kompjuterike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• E drejta për privatësi</li> <li>• E drejta personale</li> <li>• Interaksione në kabinetin e kompjuterëve</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Diskutim me shembuj dhe mendime me qëllim të kuptimit dhe zbatimit të drejtës për sjellje etike në kabinetin e informatikës.</li> </ul>

## KOMPJUTORËT

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të njihet me strukturën e kompjuterit;</li> <li>ti njohë elementet kryesore ndërtuese të kompjuterit dhe ti identifikojë funksionet e tyre elementare.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Pjesa makinerike – hardueri.</li> <li>Pjesa programore – softueri.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Njësia qendrore, pajisjet hyrëse, pajisjet dalëse, memoria, bit, bajt, memoria qendrore, RAM, ROM, memoria transmetuese, Memoria e jashtme.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Diskutimi për ndërtimin e kompjutorëve, duke e shfrytëzuar pajisjen në shkollë;</li> <li>Njohja dhe diskutimi për lloje të memorieve (RAM, ROM, memoria transmetuese);</li> <li>Krahasimi i llojeve të ndryshme memories transmetuese sipas kapacitetit.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>të mund të njohë, të klasifikojë dhe aktivisht të merr pjesë në lloje të ndryshme të lojërave kompjuterike.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Lojërat kompjuterike (definicioni, elementet kryesore, lloje të ndryshme të lojërave kompjuterike, lojëra arsimore)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rregullat e lojës, niveleve, qëllimi i lojës, strategjia.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Prezantimi i qëllimeve, karakteristikave, rregullave dhe kërkesave për lojërat qasëse nga vetë nxënësit.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>ti njohë operacionet elementare të sistemit operativ dhe drejtë ti realizojë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sistemet operative.</li> <li>Operacione themelore në sistemin operativ (punë me ikona dhe dritare, datoteka dhe follderë).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Sistemi operativ, sipërfaqja e punës, datoteka, programe, ikona, follderë, dritare.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>„Zbulimi“ i funksioneve të sustave të miut dhe tastierës dhe diskutimit.</li> <li>Realizimi i ushtrimeve dhe detyrave praktike me sistemin ekzistues operativ: ndezja e kompjuterit, krijimi i follderëve, kopjimi dhe përlllogaritja.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>ti njohë mundësitë të programeve ndihmëse për përpilimin e tekstit dhe ti përdorë.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Programet ndihmëse për përpilimin e tekstit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Alfabeti, fondi ,stili, barazimi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Shfrytëzimi i pajisjeve hyrëse për të shkruar dhe rregulluar tekstin.</li> </ul>

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të aftësohet ta shfrytëzojë kalkulato- rin elektronik.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kalkulatori elektronik</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Operacione me numra</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hulumtimi i mundësive të kalkulatorit elektronik</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ta vërejë dobinë nga përdorimi i softuerit arsimor;</li> <li>• të dijë të shfrytëzojë softuer arsimor të përshtatshëm.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Softuer arsimor</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Softuer arsimor</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Prezantimi dhe shfrytëzimi i softuerit arsi- mor të përshtatshëm</li> </ul>

### MULTIMEDIA

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• ti përdorë programet për punë me tin- guj dhe videopërshkrime.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nocioni për multimedia</li> <li>• të zëshme dhe videopër- shkrime</li> <li>• Incizim dhe riprodhim</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Multimedia, datotekë multi- mediale, të zëshme dhe video- përshkrime, kodeks.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njohja me programet multimediale të siste- mit ekzistues operativ.</li> <li>• Gjetja dhe aktivizimi të zëshmeve dhe vi- deopërshkrimeve;</li> <li>• Të shtuarit e efekteve.</li> </ul>

## INTERNET

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>të njihet me elementet elementare të rrjetit kompjuterik.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rrjeti kompjuterik (qasje, marrja dhe ruajtja e datotekave)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Rrjeti kompjuterik</li> <li>Kompjuter server</li> <li>Kompjuter klient</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Njohja me rrjetin kompjuterik shkollor</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>të njohë lloje të ndryshme të shërbimeve të Internetit dhe të aftësohet të përdorë ueb-faqet.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Internet-shërbime (servise)</li> <li>Rregulla të sjelljes në Internet</li> <li>Ueb-terminologjia (sajt, faqe, adresë, publikim, postim...)</li> <li>Ueb-shfletuese</li> <li>Ueb-kërkuese</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Internet WWW</li> <li>Ueb-kërkues</li> <li>Ueb-shfletues</li> <li>Ueb -faqe</li> <li>Fjalë kyçe</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Njohja me Internet dhe mundësitë që i ofron;</li> <li>Qasje në Internet përmes Programit Internet-shfletuesit;</li> <li>Njohja me qëllimin, mundësitë dhe rëndësinë e ueb- kërkuesve;</li> <li>Kërkimi sipas kriterëve të shumta.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>Ti shfrytëzojë mundësitë e portalit arsimor.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Portali arsimor</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>Portali arsimor ,</li> <li>Posta elektronike,</li> <li>Kurse elektronike,</li> <li>Forumi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>E shfrytëzon portalin arsimor për: <ul style="list-style-type: none"> <li>- krijime dhe punë me postë elektronike;</li> <li>- i shfrytëzon kurset elektronike për plotësimin të njohurive dhe shkathtësive të tyre për pjesën nga përmbajtjet mësimore;</li> <li>-e shfrytëzon forumin për nxënës për këmbimin e përvojave dhe informatave me nxënësit tjerë.</li> </ul> </li> </ul>

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Ta kuptoj nevojën nga përdorimi i programit për kundërvirus</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Programi kundërvirus</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Virus kompjuteri</li> <li>• Programi kundërvirus</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njohja me lloje të viruseve kompjuterik;</li> <li>• Demonstrimi i mënyrës i shfrytëzimit të programit kundërvirus i cili është në dispozicion.</li> </ul>
<ul style="list-style-type: none"> <li>• Të aftësohet për të përdorur postë elektronike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Posta elektronike</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Postë elektronike</li> <li>• Adresë elektronike</li> <li>• Emri i shfrytëzuesit</li> <li>• Pasvordi</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Njohja me postën elektronike;</li> <li>• Krijimi i adresave elektronike dhe operacioneve me porosi elektronike.</li> </ul>

### BAZAT E VIZATIMIT

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
<p>Nxënësi/nxënësjja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të njihet me mundësitë dhe veglat e programit për vizatim;</li> <li>• të aftësohet të krijojë dhe rregullojë vizatime (dmth., të ndryshojë karakteristika).</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nocioni për grafikën kompjuterike (pikturë,vizatim,fotografi dhe formatet e tyre)</li> <li>• Krijimi dhe ruajtja e vizatimit</li> <li>• Shfrytëzimi i paletës për ngjyra dhe vegla për vizatim</li> <li>• Karakteristikat e vizatimit</li> <li>• Futja e tekstit</li> <li>• Vizatimi i figurave gjeometrike</li> <li>• Vizatim me dorë të lirë</li> <li>• Punë me pjesë nga vizatimi</li> <li>• Ndryshimi i karakteristikave të vizatimit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Grafika kompjuterike</li> <li>• Piksel</li> <li>• Rezolucion</li> <li>• Paleta e ngjyrave</li> <li>• Prerje-pjesë nga vizatimi</li> <li>• Operacione me vizatim (kopjim, prerje, rotacion, zmadhim, etj)</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Punë hulumtuese dhe praktike me qëllim:</li> <li>- përdorimi i drejtë pajisjeve hyrëse për krijimin dhe ndryshimin e vizatimit;</li> <li>- shfrytëzimi i paletës për ngjyra, si dhe veglave për vizatim;</li> <li>- ndryshimi i karakteristikave të vizatimit;</li> <li>- futja e pikturave dhe tekstit të gatshëm.</li> </ul>

## PËRPUNIMI I TEKSTIT

Qëllimet	Përmbajtjet	Konceptet	Aktivitetet dhe metodat
<p>Nxënësi/nxënësja:</p> <ul style="list-style-type: none"> <li>• të njihet me urdhëresat dhe veglat e programit për të shkruar tekst;</li> <li>• të aftësohet të krijojë dhe të rregullojë tekst;</li> <li>• të aftësohet të fusë objekte dhe tabela në tekst.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Nocioni për programin për rregullimin e tekstit</li> <li>• Të shkruarit e tekstit</li> <li>• Rregullimi i testit</li> <li>• Operacione me tekst (madhësia, stili, ngjyra ...)</li> <li>• Krijimi i objekteve grafike dhe futja e ilustrimeve të gatshme</li> <li>• Lloje të numërimit automatik</li> <li>• Punë me tabela (operacione të rëndomta)</li> <li>• Printimi i dokumentit</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Shkronja</li> <li>• Fonti</li> <li>• Stili</li> <li>• Nivelim</li> <li>• Përkrahja gjuhësore</li> <li>• Simbolet</li> <li>• Objekti.</li> </ul>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Punë hulumtuese dhe praktike me qëllim:             <ul style="list-style-type: none"> <li>- rregullimi i tekstit;</li> <li>- futja e objekteve, ilustrime dhe simbole në tekst;</li> <li>- formatimi i tekstit duke shfrytëzuar mundësinë e llojeve të ndryshme të numërimit;</li> <li>- ndryshimi i karakteristikave në tabelë;</li> <li>- përgatitja e dokumentit për botim/printim;</li> <li>- marrja e teksteve dhe objekteve nga Interneti dhe rregullimi i tyre sipas parametrave të dhënë.</li> </ul> </li> </ul>

## 4. REKOMANDIME DIDAKTIKE

Lënda mësimore *Informatikë* në klasën e VI mësohet 2 orë në javë, përkatësisht 72 orë në vit në lëndët e detyrueshme.

### *Rekomandime për shfrytëzimin e fondit vjetor të orëve*

Për secilin lëmi të paraparë është caktuar fondi vjetor i orëve, përkatësisht:

- Bazat e informatikës – 8 orë;
- Kompjuteri – 18 orë;
- Multimedia – 6 orë;
- Interneti – 12 orë;
- Bazat e vizatimit – 12 orë dhe;
- Përpunimi i tekstit – 16 orë.

Nga fondi i plotë i paraparë i orëve sipas lëmvive programore janë lejuar disa lëshime në pajtim me specifikat e mjedisit në të cilin gjendet shkolla. Gjithashtu, në kuadër të fondit të përgjithshëm vjetor të orëve në lëmit programore, janë lejuar lëshime edhe në shpeshhtësinë e qëllimeve, përmbajtjeve dhe aktiviteteve konkrete. Njëherësh, numri i orëve duhet të ripërvetësohet ndaj nevojave të shkollës konkrete (mjedisit jetësor nga e cila vijjnë nxënësit, statusi i tyre arsimor, kulturor, përgatitja paraprake e nxënësve, përgatitja paraprake e nxënësve në punë me kompjuter). Në atë kontekst disa përmbajtje do të përsëriten shumë herë në llogari të të tjerëve të cilët do të punojnë me fond më të vogël të orëve. Gjithashtu, rekomandohet fleksibiliteti në kohëzgjatjen e orëve në funksion të nevojave dhe interesave të nxënësve.

### *Mjetet mësimore:*

- libër për informatikë i zgjedhur në nivel të shkollës dhe lejuar nga ministri;
- burime tjera të mësimit në mjedisin e drejtpërdrejtë: gjësende dhe dukuritë në natyrë, si dhe dukuritë në shoqëri dhe raportet mes njerëzve;

- enciklopedi, fjalorë, atlase, harta etj.;
- Internet, softuer arsimore;
- revista;
- mjete audiovizuale.

## 5. VLERËSIMI I TË ARRITURAVE TË NXËNËSVE

Gjatë mësimit të informatikës në klasë të VI rekomandohet përcjellja formative e cila përfshinë përpunimin dhe udhëheqjen e portfolios së nxënësve e cila përfshinë:

- grumbullimin e treguesve (përpunime të nxënësve në kompjuter) për secilin nxënës në veçanti;
- vazhdimësinë (formative) të përgatitura paraprakisht në fletëzat evolutive për secilin nxënës, të cilat përpunohen pas çdo aktiviteti të tyre konkret e cila është specifike.

*Gjatë mësimit, në bazë të njohurisë nga vlerësimi formativ krijohet vlerësimi përshkrues dhe numerik, kurse në mbarim të vitit mësimor bëhet me vlerësim numerik.*

### **Mënyra e kontrollimit dhe vlerësimit**

Në pajtim me natyrën e programit nga lënda e informatikës në klasë të VI vlerësimi duhet të realizohet: me gojë, me praktikë, me prezantim etj.

Mjete dhe veprime tjera për ndjekje dhe vlerësim:

- fleta kontrolluese;
- detyra shtëpie;
- teste të njohurive.

## 6. KUSHTET HAPËSINORE PËR REALIZIMIN E PROGRAMIT MËSIMOR

Sipas normativit për hapësirë, pajisje dhe mjete mësimore nga informatika dhe teknika kompjuterike në shkollë. Programi sa i përket kushteve hapësinore bazohet në Normativin për hapësirë, pajisje dhe mjete mësimore për arsimin fillor nëntëvjeçar miratuar nga ministri i Arsimit dhe Shkencës me vendim nr. 07-1830/1 më 28.02.2008.

## 7. NORMATIVI PËR KUADRIN MËSIMOR

- Studime të mbaruara nga informatika VII<sup>1</sup>, drejtimi arsimor;
- matematikë-informatikë VII<sup>1</sup>, drejtimi arsimor;
- teknika kompjuterike informatikë dhe automatikë, VII<sup>1</sup> me përgatitje pedagogjike - psikologjike dhe metodike;
- studime të kryera nga lëmi i informatikës, teknologjitë informatike ose informatike - komunikuese në universitetet e akredituara në RM ose jashtë vendit me akreditim nga vendi, VII<sup>1</sup>, me përgatitje pedagogjike - psikologjike dhe metodike .

Programin mësimor nga *informatika* për klasën e VI në arsimin fillor nëntëvjeçar e solli ministri i Arsimit dhe Shkencës me vendim nr. 07-4100/1 me 22.05.2008.